


KONTAKT

2025

# DETAIL







NdrysHE...

**Përmbajtja**

## Contents

**Sigurim Teknik**

## Technical Assurance

- 8 **Vinç**  
Crane
- 10 **Skela**  
Scaffolding
- 12 **Mbrojtja nga rënia**  
Fall Protection
- 14 **Rrethim Ndërtimi**  
Construction Fencing
- 16 **Tabela Sinjalizuese**  
Warning Signs

**Konstruksioni**

## Construction

- 20 **Gjeodezi**  
Geodesy
- 22 **Gërmime**  
Excavations
- 24 **Përforcim tabani**  
Soil reinforcement
- 26 **Shtresë e pastër**  
Plain concrete filling layer
- 28 **Pilota**  
Piles
- 30 **Beton**  
Concrete
- 32 **Hekur**  
Steel
- 34 **Lëvozhgë vertikale**  
Vertical framework
- 36 **Lëvozhgë horizontale**  
Horizontal framework
- 38 **Dysheme industriale**  
Industrial Floor
- 40 **Rampë kurriz peshku**  
Herringbone ramp
- 42 **Fugë diletacion**  
Dilatation joint
- 44 **Gropë ashensori hidroizolim**  
Elevator pit waterproofing
- 46 **Nëntokë hidroizolim**  
Underground waterproofing
- 48 **Depo uji hidroizolim**  
Watertank waterproofing
- 50 **Zinxhir hidroizolim**  
Waterproofing chains
- 52 **Tarracë hidroizolim**  
Roof waterproofing
- 54 **Ajrues**  
Air Vents

**18**

Planifikimi dhe organizimi i saktë i materialeve dhe pajisjeve është çelësi i suksesit dhe cilësisë së projektit.

Proper planning and organization of materials and equipment is the key to project success and quality.

**76**

Detajet e grilave, dritarja dhe ngjyra e bardhë krijojnë një hapësirë të ndriçuar dhe elegante.

The details of the grilles, window, and white color create a bright and elegant space.



- 56 **Muraturë**  
Masonry
- 58 **Penobeton**  
Lightweight concrete
- 60 **Nënshtresë**  
Lightweight screed
- 62 **Suvatim**  
Interior Plaster
- 63 **Fino**  
Skim coat
- 64 **Bojatisje**  
Painting

---

## Fasada

### Façades

- 68 **Sistem kapotë**  
Etics
- 70 **Dritare**  
Windows
- 72 **Grilë**  
Roller shutter
- 74 **Davancial**  
Window sills
- 76 **Parapet xhami**  
Glass railing
- 78 **Parapet kangjella**  
Railing

---

## Teknika e Shtëpisë

### Home Appliance

- 82 **Derë objekt**  
Building entrance door
- 84 **Derë e jashtme**  
External door
- 86 **Derë e brendshme**  
Interior door
- 88 **Ashensor**  
Elevators
- 90 **Kangjella në shkallë**  
Stair rails
- 92 **Tualet dhe llozha hidroizolim**  
The waterproofing of bathrooms and loggias
- 94 **Pllakë**  
Tiles
- 96 **Laminat**  
Laminate
- 98 **Kuti poste**  
Mail box
- 100 **Portë parkimi**  
Parking door
- 102 **Vijëzim parkimi**  
Parking area signs
- 104 **Tabelizim objekt**  
Directional signs

Kursimi i energjisë, izolimi akustik, mbrojtja nga uji dhe qëndrueshmëria afatgjatë – koncepti i sistemit ETICS në fasadat rezidenciale.

Energy-saving, noise-insulating, weatherproof, and long-lasting. This is the concept of the ETICS system applied to residential facades.

# 70



# 78

Ajri i pastër dhe qetësia përforcojnë ndërtimin e shtëpisë.

Clean air and tranquility enhance the construction of the house.



## Elektrike

Electrical

- 108 **Rrufepritës**  
Lightningrod
- 109 **Tokëzim**  
Earthing
- 110 **Kabina elektrike**  
Electrical cabin
- 112 **Instalime elektrike**  
Electrical installations
- 114 **Tv, Internet**  
Tv, Internet
- 116 **Fruta elektrike**  
Electrical parts
- 118 **Ndriçim**  
Lighting
- 120 **Ndriçim vinç**  
Crané lighting
- 122 **Testime elektrike**  
Electrical tests

## Mekanike

Mechanical

- 126 **Stacion pompa**  
Pump ptation
- 128 **Matësa uji**  
Water meters
- 130 **Furnizim ujë objekt**  
Water supply network
- 132 **Furnizim ujë apartament**  
Apartaments water supply
- 134 **Rakorderi presioni**  
Pressure regulator
- 136 **Kondicionim**  
Air conditioning
- 138 **Hidrosanitare**  
Plumbing fixtures
- 142 **Aspirim i dedikuar**  
Ventilation
- 144 **Drenazhim parkim**  
Parking drainage
- 146 **Kanalizim ujëra**  
Wastewater
- 148 **Mbrotja kundra zjarrit**  
Fire protection



# 106

Thjeshtësia, drita natyrale dhe hapësira e organizuar janë elementët kryesorë të objektit, me dyer, dritare dhe dysheme të konceptuara për stil dhe komoditet.

Simplicity, natural light, and well-organized spaces are the first elements you notice in the villa. Doors, windows, wall coverings, and floors are designed for style and comfort.

# 162

Ndriçimi i jashtëm krijon një atmosferë të ngrohtë dhe tërheqëse për hapësirat e jashtme.

Outdoor lighting creates a warm and inviting atmosphere for exterior spaces.





# 168

Detajet janë ato që bëjnë  
diferencën në ndërtim,  
duke i dhënë karakter dhe  
përsosmëri çdo projekti.

Details are what make the  
difference in construction,  
giving character and  
perfection to every project.

## Sisteme të Jashtme Landscape

- 152 **Gjelbërim**  
Vegetation
- 154 **Rrugë**  
Road
- 156 **Trotuar**  
Sidewalk
- 158 **Tabela orientuese**  
Directional signs
- 160 **Vijëzime**  
Road markings
- 162 **Ndriçimi i jashtëm**  
Outdoor lighting
- 164 **Mur mbajtës betoni**  
Retaining concrete wall
- 166 **Mur mbajtës i gjelbëruar**  
Retaining green wall
- 168 **Shkallë të jashtëm**  
External staircase
- 170 **Kangjella të jashtme**  
Exterior railings
- 172 **Biçikleta mbajtëse**  
Bike holders
- 174 **Stola**  
Benches
- 176 **Lodra për fëmijë**  
Playground

Ambienti ku jetojmë,  
përfshirë gjelbërimin,  
sistemet e jashtme dhe  
hapësirat për argëtim,  
kontribuon në cilësinë  
e jetesës dhe forcimin  
e lidhjeve sociale.

The environment  
we live in, including  
greenery, outdoor  
systems, and  
recreational spaces,  
enhances the quality  
of life and strengthens  
social connections.

# 150




# Sigurim Teknik

Technical Assurance





# Vinç Crane



Prerje  
Shkalla 1:1000

- 1 Baraspesha
- 2 Parapet Mbrojtës
- 3 Kulla
- 4 Kabina operuese
- 5 Direk
- 6 Grep

Section,  
Scale 1:1000

- 1 Counterweight
- 2 Guardrail
- 3 Tower
- 4 Operator's cab
- 5 Mast
- 6 Hook




Vinci Potain Model Igo T 85 është ideal për kantieret e ndërtimit në rezidenat e banimit që Kontakt ndërton. Ato janë me lartësi 30 m dhe krah 38 m duke mbulur me rrezen e tij objekte deri në 12 kate. Në çdo kantier, montimi, çmontimi dhe mirëmbajtja kryhen nga montatorë të kualifikuar dhe çertifikuar në Gjermani. Përdorimi i tij siguron shpejtësi dhe siguri në transportin e materialeve në lartësi. Vinçi është i pajisur me ndriçim LED në gjithë gjatësinë, duke shërbyer edhe si pikë referimi gjatë natës për kantieret në Tiranë.

The Potain Crane, Model Igo T 85 is ideal for construction sites of residential buildings that Kontakt constructs. It has a height of 30 m and a reach of 38 m, covering structures up to 12 floors. At every site, assembly, disassembly, and maintenance are carried out by qualified and certified technicians from Germany. Its use ensures speed and safety in transporting materials at height. The crane is equipped with LED lighting along its entire length, serving as a reference point at night for construction sites in Tirana.



# Skela

## Scaffolding



Prerje  
Shkalla 1:100

- 1 Pedanë çeliku
- 2 Parapet mbrojtës
- 3 Kornizë çeliku
- 4 Shkallë
- 5 Bazë e rregullueshme
- 6 Tra Kapriatë

Section,  
Scale 1:100

- 1 Steel deck
- 2 Guardrail
- 3 Assembly steel frame
- 4 Acces ladder
- 5 Adjustable base
- 6 Lattice beam





Skelat Layher, sistemi SpeedyScaff, përdoren për veshjen e fasadave të objekteve gjatë ndërtimit të strukturave beton-arme dhe deri në përfundimin e punimeve të fasadave. Ky sistem modern dhe fleksibël skelash ofron stabilitet dhe siguri të lartë, duke lejuar montim të shpejtë dhe të sigurtë. Veshja e objektit me skela është një nga proceset më të rëndësishme në kantieret e Kontakt, pasi rrit sigurinë e punonjësve gjatë punimeve në lartësi, duke ofruar një mjedis të mbrojtur për realizimin e detyrave në pjesët e jashtme të ndërtesës.

Layher Speedy Scaff system is used to cover the facades of the buildings during the construction of the reinforced concrete structure until the completion of the facade works. This modern and flexible scaffolding system offers high stability and safety, allowing for quick and safe assembly. Covering the building with scaffolding is one of the most important processes at Kontakt construction sites, as it enhances worker safety during tasks at height, providing a protected environment for carrying out work on the exterior parts of the building.


## Mbrojtja nga rënia

### Fall protection

Në kantieret tona të ndërtimit, mbyllja e shunteve të ashensorëve dhe puseve teknike realizohet me barriera mbrojtëse provizore, të montuara me profile metalike. Këto barriera janë të dizenuara dhe të montuara për të parandaluar rëniet aksidentale. Sigurojnë mbrojtje të përkohshme efektive për punonjësit gjatë punimeve. Vendosja e tyre është e domosdoshme për të mbajtur sigurinë në kantier, veçanërisht në zonat me rrezik të lartë, duke minimizuar aksidentet dhe rreziqet gjatë ndërtimit. Kjo zgjidhje provizore respekton standardet e sigurisë në ndërtim.

At our construction sites, the enclosure of elevator shafts and technical wells is achieved with temporary protective barriers, installed using metal profiles. These barriers are designed and installed to prevent accidental falls. They provide effective temporary protection for workers during their works. Their installation is essential for maintaining safety on the site, especially in high-risk areas, minimizing accidents and hazards during construction. This temporary solution complies with the safety standards in construction.





Prerje,  
Shkalla 1:40

- 1 Profile metalike të salduara në mur
- 2 Pllakë themeli beton i armuar
- 3 Gropë ashensori
- 4 Tokë natyrore


Section,  
Scale 1:40

- 1 Welded metal profiles
- 2 Reinforced concrete slab foundation
- 3 Elevator pit
- 4 Soil



# Rrethim ndërtimi

## Construction fencing



Prerje,  
Shkalla 1:30

Section,  
Scale 1:30

1 Profil tubolar  
2 Rrjetë jeshile

1 Tubular profiles  
2 Green mesh

Në kantierin e ndërtimit, rrethimi i pronës realizohet me rrjete jeshile të montuar mbi profile tubolare metalike. Pjese e rrethimit është dhe porta hyrëse e cila është me mekanizëm rrëshqitës, e lehtë për përdorim dhe e sigurtë. Piketimi i saktë i pronës dhe rrethimi bëhet nga inxhinieri gjeodet, duke përdorur instrument matës total station, sipas kufijve të pronës të përcaktuara në lejen e ndërtimit. Ky rrethim siguron kufizimin e hapësirës së punimeve dhe mbrojtjen e zonës përreth nga ndërhyrjet e paautorizuara.


At the construction site, the property is enclosed with green nets mounted on metal tubular profiles. Part of the fencing includes an entrance gate, which features a sliding mechanism, making it easy to use and secure. The precise marking of the property and the enclosure is carried out by a surveyor using a total station, according to the property boundaries specified in the building permit. This fencing ensures the limitation of the work space and protects the surrounding area from unauthorized interference.

Prerje,  
Shkalla 1:50

Section,  
Scale 1:50

- 1 Profil 120x120 mm
- 2 Rrjetë me fiksues perimetral
- 3 Profil 60x20 mm
- 4 Profil 60x60 mm
- 5 Portë për njerëz
- 6 Portë për mjete

- 1 Profile 120x120 mm
- 2 Mesh with perimetral fasteners
- 3 Profile 60x20 mm
- 4 Profile 60x60 mm
- 5 People's Gate
- 6 Vehicles's Gate



# Tabela sinjalizuese

## Warning signs

Në kantieret tona të ndërtimit rëndësi e veçantë i kushtohet tabelizimit dhe sinjalistikës së kantierit. Kjo sepse kantieret zhvillohen në sipërfaqe të mëdha trualli, ku fluksi i punonjësve dhe qarkullimi është shumë i madh.



Tabelat sinjalizuese përdoren për të informuar dhe për të paralajmëruar çdo person që akseson zonën. Ato udhëzojnë qartë për rreziqe të mundshme si dhe për rregullat e sigurisë dhe pajisjeve mbrojtëse. Vendosen në pika kyçe për të siguruar që punëtorët, vizitorët dhe kalimtarët të jenë të vetëdijshëm për rregulloret e kantierit, duke minimizuar kështu rrezikun e aksidenteve. Tabela specifike sinjalizojnë qarkullimin e mjeteve brenda kantierit, duke përcaktuar rrugët e lëvizjes për makineritë dhe këmbësorët, si dhe theksojnë rëndësinë e mbajtjes pastër të mjedisit përreth kantierit, duke u kujtuar punonjësve të ruajnë rendin dhe të eliminojnë mbetjet në mënyrë periodike. Përdorimi i tabelave sinjalizuese garanton një mjedis të sigurt pune dhe të organizuar.

In our construction sites, special emphasis is placed on site warning and obligatory signs. This is important because our construction sites cover large areas, where the flow of workers and traffic is very high.



Warning signs are used to inform and alert anyone accessing the area. They provide clear guidance on potential hazards as well as safety rules, and the use of protective equipment. Signs are placed at key points to ensure that workers and visitors are aware of the site regulations, thereby minimizing the risk of accidents. Specific signs indicate vehicle traffic within the site, defining movement paths for vehicles and pedestrians, and emphasizing the importance of keeping the surrounding environment clean, reminding workers to maintain order and periodically dispose of waste. The use of warning signs ensures a safe and organized working environment.



1



2



3



4



5



6



7



8



9

Prerje  
Shkalla 1:100

- 1 Raportim, Vizitor në Kantier
- 2 Raportim, Aksidente në Kantier
- 3 Sigurim Teknik, Jeleku i Kantierit
- 4 Sigurim Teknik, Pajisje Sigurimi
- 5 Sigurim Teknik, Kokore Kantieri
- 6 Sigurim Teknik, Këpucë Kantieri
- 7 Paralajmërim, Kantier Ndërtimi
- 8 Paralajmërim, Ndalim Hyrje Fëmijësh
- 9 Paralajmërim, Ndalim Hyrje Paautorizim

Section,  
Scale 1:100

- 1 Reporting, Site Visitors
- 2 Reporting, Site Accidents
- 3 Technical Protection, Site Vest
- 4 Technical Protection, Site Protection Tools
- 5 Technical Protection, Site Helmet
- 6 Technical Protection, Site Footwear
- 7 Warning, Construction Site
- 8 Warning, Child Entry Prohibition
- 9 Warning, Prohibition of Unauthorized Access

# Konstruksioni

## Construction






# Gjeodezi

## Geodesy

Shperndarja e matjeve  
Distribution of measurements



Rëndësi të lartë i kushtohet saktësisë dhe procesit të matjeve gjeodezike në ndërtimin e objekteve tona. Për këtë arsye përdorim instrumentat matës të fjalës së fundi të teknologjis të kompanisë Trimbe që janë Total Station SX12 me të cilët realizohen proceset e piketimit të çdo detaji për konture dhe linja në plan dhe lartësi si dhe kontrollet gjatë zbatimit me LaserScanner.

High importance is given to the accuracy and process of geodetic measurements in the construction of our buildings. For this reason, we use the latest technology measuring instruments from Trimbe, such as the Total Station SX12, with which the processes of marking each detail for contours and lines in plan and height are carried out, as well as controls during implementation with LaserScanner.

- Toleranca lejuar (-)  
Tolerance Allowed (-)
- - - - Toleranca lejuar (+)  
Tolerance Allowed (+)
-  Kurba e matjeve  
Measurement curve



Përdorimi i instrumentave matës të tipit Total station dhe GPS rrit shkatësinë në realizimin e proceseve dhe shkurton kohën e realizimit duke dhënë në kohë reale me anë të rlevimeve që realizohen raportin e vologeve të gërmimit dhe mbushjeve. Piketimi i çdo detaji me anë të Total Station SX12 na ndihmon në ndërtimin e strukturave të rregullta gjeometrikisht dhe me precizion të lartë.


The use of measuring instruments of the Total station and GPS type increases the efficiency in the realization of the processes and shortens the realization time, giving in real time through the surveys, the ratio of the excavation and filling volumes. Pinpointing every detail with Total Station SX12 helps us build geometrically regular structures with high precision.


# Gërmime

## Excavations

Gërmimi është procesi i parë në fillimin e një kantieri në të cilin largohen dherat duke arritur formacionin e përcaktuar në raportin gjeologjik. Ky proces realizohet duke i'u përmbajtur të gjitha sugjerimeve në projektin konstruktiv. Gjithmonë përpara fillimit të gërmimit sigurohemi të ruajmë qëndrueshmërin e objekteve kufitare dhe drenazhimin e ujrave sipërfaqësore. Gërmimi realizohet duke zbatuar raportin 1:1 për pjerrësinë e skarpatave.

The excavation is the first process when starting a construction site, in which the soils are removed reaching the formation specified in the geological survey. This process is carried out by adhering to all the suggestions in the constructive project. Always before starting excavation we make sure to maintain the stability of border objects and surface water drainage. Excavation is carried out by applying 1:1 ratio for the inclination of the slopes.





Prerje,  
Shkalla 1:100

- 1 Pilota D=70/135 cm
- 2 Sistemime
- 3 Terreni natyror
- 4 Gërmim
- 5 Nënshtrëse betoni
- 6 Dhe i hedhur i ngjeshur

Section,  
Scale 1:100

- 1 Piles D=70/135 cm
- 2 Landscape
- 3 Subsoil
- 4 Excavation
- 5 Screed
- 6 Compacted soil



# Përforcim Tabani


## Soil reinforcement

Prerje,  
Shkalla 1:150

Section,  
Scale 1:150


- 1 Sistemime
- 2 Mbushje deri në sistemim
- 3 Terreni natyror
- 4 Mbushje zhavorri
- 5 Gërmim

- 1 Landscape
- 2 Filling until systematization
- 3 Subsoil
- 4 Gravel fill
- 5 Excavation



Përforcimi i tokës është procesi i cili realizohet për të rritur aftësinë mbajtëse të bazametit në rastet kur nuk arrihet minimum i aftësisë mbajtëse në projektin konstruktiv. Ky proces realizohet duke gërmuar terrenin deri në momentin që arrijmë shtresën e tokës e përcaktuar në profilin gjeologjik dhe më pas për të kapur kuotën e tabanit të themelit realizohet mbushje me material me karakteristika të përcaktuar në projekt dhe të analizuar në laborator.

Soil reinforcement is the process that is carried out to increase the bearing capacity of the foundation in cases where the minimum bearing capacity is not reached in the construction project. This process is carried out by excavating the ground until we reach the soil layer defined in the geological profile, and then in order to capture the quota of the base of the foundation, it is filled with material with characteristics defined in the project and analyzed in the laboratory.



Mbushja realizohet me shtresa çdo 20 cm të ngjeshura me rrul. Për të siguruar një ngjeshje kompakte me koeficient ngjeshje 98% dhe aftësi mbajtëse të njëtrajtëshme brenda minimumit të kerkuar realizohen prova statike me pjastra në kantier. Në rastet kur kuotat e gërmimit janë shumë poshtë dhe krijojnë skarapata të paqëndueshme përforcimi i bazmanetit realizohet me pilota betoni me klasë C12/15 të cilat shërbejnë për transferimin e ngarkesës nga themeli në tokën me formacion të mirë.

Filling is done with layers every 20 cm compressed with a roller. In order to ensure a compact compression with a coefficient of 98% and a standard bearing capacity within the required minimum, static tests with plates are carried out on site. In cases where the excavation quotas are too low and create unstable cracks, the reinforcement of the foundation is done with concrete piles of class C12/15 which serve to transfer the load from the foundation to the soil with a good formation.


## Shtresë e pastër

### Plain concrete filling layer



Shtresë betoni me trashësi 2-10 cm me klasë C12/15 cm e cila betonohet pas përfundimit të gërmimit dhe përfocimit të bazamentit . Kjo shtresë shërben për të krijuar një sipërfaqe të rrafshët horizontale në mënyrë që të respektojmë shtresën mbrojtëse të armimit të themelit si edhe për të shmangur kontaktin e drejtpërdrejtë të hekurit me dheun. Gjithashtu ka dhe një funksion ndihmës për fiksimin e lëvozhgës dhe krijimin e formës gjeometrike të themelit.

This is a concrete layer with a thickness of 2–10 cm and a grade of C12/15, applied after the excavation and foundation reinforcement. This layer provides a flat horizontal surface to maintain the protective reinforcement cover of the foundation and prevents direct contact between the rebar and the soil. It also aids in fixing the formwork and creating the geometric shape of the foundation.



Prerje,  
Shkalla 1:20

- 1 Dysheme industriale
- 2 Pllakë themeli B/A
- 3 Shtresë e pastër
- 4 Tokë natyrore

Section,  
Scale 1:20

- 1 Industrial floor
- 2 Ribbed slabbed foundation B/A
- 3 Concrete filling
- 4 Subsoil





# Pilota

## Piles

Elemente betoni të armuara me seksion rrethor dhe diametër 70 cm dhe klasë betoni C 25/30 të cilat projektohen bazuar në normativat shqiptare KTP N2-89 dhe normat europiane të projektimit Eurocode 2 dhe Eurocode 8. Vendosen në perimetër të godinave referuar planit të gërmimit për të siguruar qëndrueshmërin e skaraptave dhe përballimin e presionit të tokës dhe ngarkesat e godinave në pjesën e sipërme të skaraptave. Thellësia e shpimit, hapi i pilotave, dhe sipërfaqja e armimit llogaritet në funksion të thellësisë së gërmimit dhe ngarkesave që ushtrojnë presion në rrjeshtin e pilotave.

Reinforced concrete elements with circular cross-sections, 70 cm in diameter, and a concrete grade of C25/30. These are designed based on Albanian standards KTP N2-89 and European design standards Eurocode 2 and Eurocode 8. Piles are placed along building perimeters as per the excavation plan to ensure slope stability and to handle soil pressure and building loads on the upper sections of slopes. The depth of drilling, pile spacing, and reinforcement area are calculated based on excavation depth and load pressures on the pile row.





Prerje,  
Shkalla 1:50

- 1 8 Ø 14
- 2 StØ 10 / 15, stafa spirale
- 3 Ø 14 / 300, unaza për montim
- 4 Ø 10 / 300, distanciatoret

Section,  
Scale 1:50

- 1 8 Ø 14
- 2 StØ 10 / 15, spiral steel
- 3 Ø14 / 300, mounting rings
- 4 Ø10 / 300, spacers



# Beton

## Concrete

Materiali bazë në krijimin e strukturës prej betoni të armuar me qëllimin kryesor për përballimin e sforcimeve shtypëse që lindin nga pesha vetjake e strukturës, ngarkesat e përkohshme dhe ngarkesat sizmike. Përbërja e betonit realizohet me çimento 42.5R dhe sipas standarteve europiane EN206-1, pra jo me më pak se  $340\text{kg/m}^3$  dhe me raport ujë/ çimento  $< 0.5$ . Për çdo betoniere që shkakton në kantier realizohet testi slump dhe merren kubikë mostra të cilat testohen në laborator. Klasat kryesore të betonit të përdorura janë C25/30 & C30/37 për elementet vertikale dhe C25/30 për elementet horizontale.

The primary material used in creating reinforced concrete structures, designed to withstand compressive strains resulting from self-weight, temporary loads, and seismic forces. Concrete composition uses cement type 42.5R in compliance with European standards EN206-1, with no less than  $340\text{ kg/m}^3$  and a water-to-cement ratio below 0.5. For each concrete mixer delivered to the site, slump tests are conducted, and cube samples are taken for laboratory testing. Common concrete grades include C25/30 and C30/37 for vertical elements and C25/30 for horizontal elements.




Prekje,  
Shkalla 1:20

- 1 Shufra metalike për përforcimin e brinjëve
- 2 Shufra metalike për përforcimin e pllakes së themelit
- 3 Pllakë betoni
- 4 Shtrese betoni e varfer

Section,  
Scale 1:20

- 1 Rib reinforcement
- 2 Slab reinforcement
- 3 Reinforced concrete
- 4 Penobeton



# Hekur

## Steel


Materiali bazë i cili së bashku me betonin krijon strukturën betonarme për të siguruar një godinë të qëndrueshme dhe funksionale. Roli kryesor i hekurit në ndërtim është për të përballuar sforcimet tërheqëse që lindin nga forcat vetjake dhe të përkohshme të stukturës si dhe nga faktorët sizmik dhe dinamik.

The base material, which, together with concrete, creates the reinforced concrete structure to ensure a stable and functional building. The main role of steel in construction is to withstand tensile strains arising from self-weight and temporary forces on the structure, as well as from seismic and dynamic factors.



Hekuri i përdorur është me vijaska për të rritur kohëzisionin midis hekurit dhe betonit dhe me diameter  $\phi 8 \sim \phi 22$ . Çeliku i përdorur është i klasit B500 B me rezistencë në tërheqje  $f_{yk} \geq 500 \text{MPa}$  dhe me zgjatim në forcë maksimale 5% duke i plotësuar të gjitha karakteristikat e duktilitetit sipas standarteve europiane të projektimit dhe zbatimit.

The steel used is ribbed steel to increase cohesion between steel and concrete, with diameters from  $\phi 8$  to  $\phi 22$ . The steel used is B500B class with tensile strength  $f_{yk} \geq 500 \text{MPa}$  and a 5% elongation at maximum strength, meeting all ductility characteristics according to European design and development standards.



Prerje,  
Shkalla 1:500

1 Armaturë Vertikale (fitila)  
2 Stafa

Section,  
Scale 1:500

1 Vertical Reinforcement  
2 Coulmn Ties

# Lëvozhgë vertikale

## Vertical framework

Punimet e kallëperisë vertikale realizohen për elementët beton-arme vertikale si muret konstruktive dhe kolonat. Kallëperia është një strukturë e përkohëshme që përdoret në strukturat beton-arme për të realizuar betonimin derisa të arrihet rezistenca e duhur e betonit .


Kallëperia duhet të plotësojë kërkesat e sigurisë dhe cilësisë sipas standartit BS EN 8500, të cilat kontrollohen nga inxhinierët gjatë gjithë kohëzgjatjes së punimeve. Synimi i Kontakt për strukturën beton-arme është realizimi i betoneve të pastra. Për këtë arsye, Kontakt bashkëpunon ngushtë me kompani lider në prodhimin e kallëperive si Paschal. Projekti i kallëperisë realizohet nga software i firmës gjermane Paschal. Materialet që përdoren për të realizuar betonimin e elementëve vertikalë janë panelet Paschal me trashësi 7,5 cm dhe dimensione të ndryshme referuar projektit, së bashku me elementë të tjerë plotësues si çelësa, puntela, prixhonierë, këndore etj. Përgjithësisht, dizarmimi i elementëve beton-arme vertikalë ndodh 2 ditë pas betonimit. Kontakt i kushton rëndësi të veçantë sigurisë në punë dhe kujdeset që para fillimit të betonimit të jenë montuar elementët e sigurisë. Qëllimi jonë është të realizojmë një produkt final shumë të mirë, që përmbush jo vetëm kërkesat teknike, por dhe ato estetike.



Vertical formwork works are carried out for vertical reinforced concrete elements such as structural walls and columns. Formwork is a temporary structure used in reinforced concrete structures to carry out the pouring process until the concrete reaches the required strength. Formwork must meet safety

and quality standards according to BS EN 8500, which are checked by the engineers during the work process. The aim of Kontakt for reinforced concrete structures is to achieve clean concrete pours. Therefore, Kontakt works closely with leading companies in formwork production, such as Paschal. The formwork project is carried out using software from the German company Paschal. The materials used to carry out the pouring of vertical elements include Paschal panels with a thickness of 7.5 cm and various dimensions according to the project, along with other supplementary elements such as supports, props, jacks, corners, etc. Generally, the stripping of vertical reinforced concrete elements occurs 2 days

after pouring. Kontakt places special importance on work safety and ensures that safety elements are installed before the concrete pouring begins. Our goal is to achieve a high-quality final product that meets both technical and aesthetic requirements.



Prerje,  
Shkalla 1:20

- 1 Panel metalik
- 2 Element për shtërngim prizhioneri
- 3 Këndore metalike


Section,  
Scale 1:20

- 1 Metallic panel
- 2 Element for prisoner clamping
- 3 Metallic corner



# Lëvozhgë horizontale

## Horizontal framework



Punimet e kallëperisë horizontale realizohen për elementët beton-armësi: trarët, soletat dhe shkallët. Kallëperia horizontale është një strukturë e përkohëshme që përdoret në strukturat beton-arme për të realizuar betonimin dhe mbështetjen e elementëve horizontalë derisa të arrihet rezistenca e duhur të betonit. Kallëperia duhet të plotësojë kërkesat e sigurisë dhe cilësisë sipas standartit BS EN 8500, të cilat kontrollohen nga inxhinierët gjatë gjithë kohëzgjatjes së punimeve. Synimi i Kontakt për strukturën beton-arme është realizimi i betoneve të pastra.

Horizontal formwork works are carried out for reinforced concrete elements such as beams, slabs, and stairs. Horizontal formwork is a temporary structure used in reinforced concrete structures to carry out pouring and support horizontal elements until the required concrete strength is achieved. Formwork must meet safety and quality standards according to BS EN 8500, checked by engineers throughout the work process. The aim of Kontakt for reinforced concrete structures is to achieve clean concrete pours.



Prerje,  
Shkalla 1:200

- 1 Prerëse dyshemeje
- 2 Nën-dysheme
- 3 Panel metalik mbajtes
- 4 Trarë

Section,  
Scale 1:200

- 1 Floor trimmers
- 2 Subflooring
- 3 Metallic retaining panel
- 4 Girders



Për këtë arsye, Kontakt bashkëpunon ngushtë me kompani lider në prodhimin e kallëperive si Doka dhe Peri. Për betonimin e elementëve horizontalë përdoren panele Peri me trashësi 1,5~2,5cm të cilët mbështeten mbi nënstrukturën e përbërë nga skela metalike, doka dhe binarë. Për monitorimin e temperaturës dhe rezistencës së betonit përdoret software Paschal Maturix, nëpërmjet të cilit përcaktohet koha e duhur e dizarmimit. Përgjithësisht, dizarmimi i elementëve beton-arme horizontalë realizohet 28 ditë pas betonimit.

Therefore, Kontakt works closely with leading companies in formwork production such as Doka and Peri. Peri panels with thicknesses of 1.5–2.5 cm are used for pouring horizontal elements, supported by a substructure made of metal scaffolding, Doka, and rails. For monitoring temperature and concrete strength, Paschal Maturix software is used, which helps determine the correct stripping time. Generally, the stripping of horizontal reinforced concrete elements occurs 28 days after pouring.

# Dysheme industriale

## Industrial floor



Sipërfaqja e dyshemesë industriale trajtohet me kuarç për të siguruar një sipërfaqe rezistente, të mbrojtur kundrejt njollave dhe abrazionit. Dyshemeja industriale trajtohet në sipërfaqe me makineri helikopter në mënyrë që të sigurohet rrafshiteti, sipërfaqe jo poroze e ashpër, uniformitet në ngjyrë dhe për një pamje sa më estetike. Në dyshemenë industriale realizohen prerjet e fugave dhe vendosja e gominave, të cilat së bashku me shiritin e polietilenit, të përdorur përgjatë çdo linje kontakti me elementët vertikale beton-arme, shmangin plasaritjet e betonit për shkak të efektit bymym-tkurrje.



The surface of the industrial floor is treated with quartz to ensure a resistant surface that is protected against stains and abrasion. The industrial floor surface is processed with a helicopter machine to ensure flatness, a non-porous rough surface, uniform color, and an aesthetically pleasing appearance. Expansion joints and rubber inserts are made in the industrial floor, and together with the polyethylene strip used along every contact line with vertical reinforced concrete elements, they prevent cracking of the concrete due to shrinkage effects.

Prekje,  
Shkalla 1:20

1 Dysheme industriale  
2 Pllakë themeli B/A  
3 Shtresë e pastër  
4 Tokë natyrore

Elevation,  
Scale 1:20

1 Industrial Floor  
2 Ribbed slabbed foundation B/A  
3 Concrete Filling  
4 Subsoil



# Rampë kurriz peshku

## Herringbone ramp

Rampat kurriz peshk realizohen në të gjitha zonat që kemi me pjerrësi në ambjentet e jashtme qoftë për levizjen e këmbësorëve si dhe për lëvizjen e automjeteve (hyrjet e parkimeve). Këto rampa realizohen nëpërmjet betonimit të një shtrese betoni me  $t=10\text{cm}$  klasë C30/35 dhe ulje konusi 22cm. Për të siguruar një koefiçient fërkimi sa më të madh sipërfaqja e betonit realizohet me dhëmbëzime 2X2 cm. Duke qenë se janë dhëmbëzime të vogla për të siguruar jetëgjatësinë e tyre realizohet trajtim i sipërfaqes me kuarz.


Herringbone ramps are constructed in all areas with slopes in outdoor environments, whether for pedestrian movement or vehicle access (parking entrances). These ramps are made by pouring a concrete layer with thickness  $t = 10\text{ cm}$ , grade C30/35, and a 22 cm cone reduction. To ensure the highest possible friction coefficient, the surface of the concrete is created with 2x2 cm dents. Since these are small dents, the surface is treated with quartz to ensure its longevity.


Prerje,  
Shkalla 1:60

- 1 Shtresë asfalti
- 2 Stabilizant
- 3 Kurriz peshku
- 4 Mbushje me zhavorr
- 5 Gjelbërim (Bar)

Section,  
Scale 1:60

- 1 Asphalt
- 2 Stabilizers
- 3 Fish ridge
- 4 Gravel filling
- 5 Vegetation





# Fugë diletacion

## Dilatation joint


Fuga e delitacionit është një hapësirë e cila lihet në struktura beton arm, për të lejuar lëvizjen e elementeve strukurore për shkak të ndryshimeve të temperaturës dhe sforcimeve strukurore. Kjo hapësirë është e nevojshme pasi materialet e përdorur në ndërtim (betoni, çeliku, etj.) zgjerohen dhe ngushtohen si pasojë e ndryshimeve të temperaturës, dhe fuga e delitacionit ndihmon në parandalimin e dëmtimeve të mundshme që mund të shkaktohen nga tensionet që krijohen gjatë këtyre lëvizjeve.

An expansion joint is a space left in reinforced concrete structures to allow movement of structural elements due to temperature changes and structural strains. This space is necessary because construction materials (concrete, steel, etc.) expand and contract as a result of temperature variations, and the expansion joint helps prevent potential damage caused by strains created during these movements.



Fuga e delitacionit përfshin hapësira të vogla mes elementeve të betonit të armuar, që mund të mbushen me materiale të veçanta elastike që lejojnë lëvizje, siç janë goma ose materiale të tjera të ngjashme. Fuga e delitacionit është një komponent kyç që siguron që struktura të mbetet e qëndrueshme dhe e paprekur nga lëvizjet natyrore që ndodhin për shkak të faktorëve të jashtëm.

The expansion joint consists of small gaps between reinforced concrete elements, which can be filled with special elastic materials that allow movement, such as rubber or other similar materials. The expansion joint is a key component that ensures the structure remains stable and unaffected by natural movements caused by external factors.



Prerje,  
Shkalla 1:20

- 1 Trotuar
- 2 Fletë Metalike Drenazhuese
- 3 Gominë Plastike
- 4 Water Stop PVC 200
- 5 XPS 2.5 cm
- 6 Llaç Hidroizolues
- 7 Fletë Drenazhuese
- 8 Fletë Hidroizoluese
- 9 Tra Betoni i Armuar
- 10 Mur Beton i Armuar
- 11 Nënshtrësë
- 12 Pllakë themeli Beton

Section,  
Section 1:20


- 1 Sidewalk
- 2 Drainage Metal Sheet
- 3 Plastic Rubber
- 4 Water Stop PVC 200
- 5 XPS 2.5 cm
- 6 Waterproof Grout
- 7 Drainage Layer
- 8 Waterproofing Layer
- 9 Reinforced Concrete Beam
- 10 Reinforced Concrete Wall
- 11 Screed
- 12 Reinforced Concrete Slab

# Gropë ashensori hidroizolim

## Elevator pit waterproofing

Gropa e ashensorit është pjesa më e ulët e objektit çka e bën të jetë më e ndikueshme nga ujrat nëntoksore. Ne realizojmë hidroizolim të saj për të penguar filtrimin e ujit dhe mbrojtjen e ashensorit. Hidroizolimi realizohet me membrane bentoniti e cila bëhet një trup me pllakën e themelit në momentin e betonimit. Bentoniti është një argjile natyrore e trajtuar me additive që bymehet në prezencë të ujit duke penguar filtrimin e tij.

The elevator pit is the lowest part of the building, making it the most affected by underground waters. We carry out its waterproofing to prevent water filtration and protect the elevator. Waterproofing is done using a bentonite membrane, which becomes one body with the foundation slab during the concrete pouring. Bentonite is a natural clay treated with additives that expand in the presence of water, preventing filtration.





Prerje,  
Shkalla 1:40

- 1 Mur Beton i Armuar
- 2 Strukturë Ashensori
- 3 DysHEME Industriale
- 4 Soletë Betoni i armuar
- 5 Tokë Natyrore
- 6 Membranë Hidroizoluese Voltex
- 7 Beton i varfër
- 8 Lam Metalike/ Gozhdë për fiksimit


Section,  
Scale 1:40

- 1 Reinforced Concrete Wall
- 2 Elevator Structure
- 3 Industrial Floor
- 4 Reinforced Concrete Slab
- 5 Subsoil
- 6 Waterproofing Layer Voltex
- 7 Lightweight Screed
- 8 Termination bar/nails



# Nëntokë hidroizolim

## Underground waterproofing



Prerje,  
Shkalla 1:30

- 1 Sistem Kapotë
- 2 Profil Kapës 40x40 mm
- 3 Profil Noppenbahn Universal
- 4 Tra B/A
- 5 XPS 80 cm
- 6 Primer HZ
- 7 Delta Thene membranë Hidroizoluese
- 8 Fletë Drenazhuese Dleta Terrax
- 9 Gushë Llaç Hidroizolues

Section,  
Scale 1:30

- 1 ETICS 10 cm
- 2 Mounting Rail 40x40 mm
- 3 Noppenbahnprofile Universal
- 4 Reinforced Beam B/A
- 5 XPS Insulation 80 cm
- 6 Waterproofing Primer
- 7 Delta Thene Waterproofing Layer
- 8 Drainage Membrane
- 9 Waterproof Grout

Hidroizolimi nëntokë realizohet me dy membra DELTA-Thene dhe DELTA-TERRAXX. Kombinimi i tyre siguron mbrojtje dhe drenazhim. DELTA-Thene është një membranë bituminoze vetëngjitëse e cila aplikohet për hidroizolime vertikale dhe horizontale. DELTA-TERRAXX është membranë drenazhuese e optimizuar për aplikime të ndryshme në kullim horizontal dhe vertikal. Përbëhet nga një fletë drenazhuese dhe një shtresë gjeotekstil, për të siguruar vetëm kalimin e ujit dhe për të penguar kalimin e materialeve të ngurta.

Underground waterproofing is achieved with two membranes, DELTA-Thene and DELTA-TERRAXX. Their combination provides protection and drainage. DELTA-Thene is a self-adhesive bituminous membrane applied for vertical and horizontal waterproofing. DELTA-TERRAXX is a drainage membrane optimized for various applications in horizontal and vertical drainage. It consists of a drainage sheet and a geotextile layer to allow only water to pass through and prevent the passage of solid materials.



Membrana hidroizoluese DELTA-THERE përshtatet për të gjitha llojet e tokës. Kujdes i veçantë duhet treguar gjatë aplikimit të DELTA-THERE, e cila duhet të vendoset vetëm në mot të thatë dhe në temperatura prej 5°C deri në 30°C. Lidhja e membranave me njëra tjetrën realizohet nga një mbivendosje prej 10 cm. Kjo membranë ka jetëgjatësi dhe durueshmëri të lartë ndaj temperaturave nga -30°C në +80°C.

The DELTA-THERE waterproofing membrane is suitable for all types of soil. Special care must be taken during the application of DELTA-THERE, which should only be installed in dry weather and at temperatures between 5°C and 30°C. The membranes are connected to each other by overlapping 10 cm. This membrane has a long lifespan and high durability against temperatures from -30°C to +80°C.

## Depo uji hidroizolim

### Watertank waterproofing

Depo e ujit hidroizolohet me Flagon AT, një material termoplastik me PVC e ideuar për përdorim në depo uji të pijshëm. Vendosja realizohet me saldim me ajër të ngrohtë. Materiali është antibakterial dhe garanton jetëgjatësi ndaj oksidimit dhe vjetërimit në ujë sipas standarteve Europiane.

The water tank is waterproofed with Flagon AT, a thermoplastic PVC material designed for use in potable water tanks. Installation is done through hot air welding. The material is antibacterial and guarantees durability against oxidation and aging in water, according to European standards.



Flagon AT është një gjeomembranë termoplastikë TPO e përforcuar me një rrjetë prej xhami prej qelqi, e projektuar posaçërisht për hidroizolim in e rezervuarëve të përdorur për ujë të pijshëm. Është rezistent ndaj ujit, nxehtësisë dhe ngricave, i papërshkueshëm nga avujt e ujit, mbetet fleksibël në një hapësirë temperaturash nga -40 °C deri në 90 °C. Për mbrojtjen e tavanit të depos së ujit nga avujt, apli-kohet lyerja me primer dhe rezinë, me funksion të dyfishtë duke siguruar kështu edhe cilësinë e ujit të pijshëm nga kontakti me betonin.


Flagon AT is a thermoplastic TPO geomembrane reinforced with a glass fiber mesh, specifically designed for waterproofing reservoirs used for drinking water. It is resistant to water, heat, and frost, impermeable to water vapors, and remains flexible in a temperature range from -40°C to 90°C. To protect the ceiling of the water tank from water vapor, a primer and resin coating is applied, serving a dual function: it ensures the quality of drinkable water by preventing contact with the concrete.

Prerje,  
Shkalla 1:30

- 1 Soletë Betoni 10 cm
- 2 Mbushje me inerte, Dysheme Teknike
- 3 Soletë Betoni i armuar
- 4 Membranë Hidroizoluese Aquafin
- 5 Mur Beton i armuar
- 6 Membranë TPO
- 7 Shtresë Hidroizolimi Delta Thene
- 8 Shtresë Drenazhuese Delta Terrax
- 9 Profil i galvanizuar me vrima të parapërgatitura

Section,  
Scale 1:30

- 1 Concrete Slab 10 cm
- 2 Inert Filling, Technical Floor
- 3 Reinforced Concrete Slab
- 4 Aquafin Waterproofing Layer
- 5 Reinforced Concrete Wall
- 6 TPO Membrane
- 7 Waterproofing Layer Delta Thene
- 8 Drainage Layer Delta Terrax
- 9 Prepunched Galvanized bar



# Zinxhir hidroizolim

## Waterproofing chains



Zinxhirët hidroizolues përdoren për të izoluar hapësirat e mbetura midis betoneve të mureve nëntokë dhe tubave të rrjetit inxhinierik, të cilët përshkojnë muret b/a dhe hidroizolim të nëntokës. Këto elementë janë të përbërë prej gominave ekspansive, të lidhura me njëra tjetrën me bulona inoksi, duke krijuar kështu zinxhirë të përmasave të ndryshme për t'iu përshatur çdo dimesnioni tubi apo çarje në murin nëntokë.

Waterproofing chains are used to seal the gaps between concrete walls in underground spaces and the pipes of the engineering network that pass through the walls and the underground waterproofing. These elements are made of expandable rubber components, connected to each other with stainless steel bolts, creating chains of various sizes to suit the dimensions of any pipe or crack in the underground wall.



Zinxhirët hidroizolues janë rezistent ndaj ujit dhe çdo lëngu tjetër, kanë rezistencë ndaj temperaturës së lartë dhe ndaj presioneve deri në 5 bar. Montimi i tyre krijon lehtësi edhe në shfrytëzimin afatgjatë të objektit, duke lejuar kështu çmontimin dhe rimontimin e tyre në rast avarie.

Waterproofing chains are resistant to water and other liquids, have high-temperature resistance, and can withstand pressures up to 5 bar. Their installation provides ease for the long-term use of the structure, allowing for disassembly and reassembly in the event of a failure.



Prerja,  
Shkalla 1:4


- 1 Mur Beton i Armuar
- 2 Vidë me rondere
- 3 Tub Plastik
- 4 Gominë Ekspansive

Section,  
Scale 1:4

- 1 Reinforced Concrete Wall
- 2 Allen head bolt
- 3 Plastic Pipe
- 4 EPDM-Rubber

# Tarracë hidroizolim

## Roof waterproofing



Hidroizolimi i tarracës realizohet me membrana hidroizoluese Evalon me trashësi 1.2 mm nga Alwitra, të cilat janë membrana sintetik PVC me cilësi të lartë, e cila mund të aplikohet në mënyrë horizontale dhe vertikale. Evaloni është një membran elastike, e përbërë nga një shtresë e vetme shumë rezistente ndaj agjenteve atmosferik dhe plotëson të gjithë kërkesat sipas DIN 18531 për tarracat e shfrytëzueshme dhe ato të pashfrytëzueshme. Për termoizolimimin e tarracave përdoret lesh guri me trashësi 10 cm me densitet 150kg/m<sup>3</sup>, duke arritur një temperaturë të përshtatshme për ambientet e brendshme.


Flat roof Waterproofing is achieved through Evalon waterproofing membranes from Alwitra, which are synthetic PVC membranes of high quality, and can be applied both horizontally and vertically with a thickness of 1.2 mm. Evalon is an elastic membrane, made of a single layer, very resistant to atmospheric agents and complete all requirements according to DIN 18531 for usable and non-usable roofs. For the thermal insulation of the roofs, rock wool with a thickness of 10 cm is used, and a density of 150 kg/m<sup>3</sup>, reaching a suitable temperature for the internal environments.

Prerje,  
Shkalla 1:20

- 1 Zhavorr lumi
- 2 Shtresë hidroizoluese Evalon V105 1.2
- 3 Gjeotekstil
- 4 Panele druri
- 5 Alwitra Kerb 1600
- 6 Baxha xhami akrilike 2S
- 7 Bosht manual për hapje
- 8 Hidro-Termo Izolim Tarrace
- 9 Barrierë Vapore

Section,  
Scale 1:20

- 1 Gravel
- 2 Evalon V 105 1.2 grey
- 3 Geotextile
- 4 Wood panel
- 5 Alwitra Kerb 1600
- 6 Acrylic glass rooflight 2S
- 7 Manual telescopic spindle
- 8 Roof Hydro-Thermo Insulation
- 9 Vapor Barrier





Realizimi i një sistemi të plotë të mbyllur të hidroizolimit të tarracave arrihet duke përdorur në të gjithë perimetrin e objektit profile metalike, të cilat lidhen me membranat dhe elementet e parapërgatitur prej Evaloni. Për të ruajtur dhe rritur jetëgjatësinë e tarracave i gjithë hidroizolimi mbulohet me një shtresë gjeoteksili dhe mbushet me zhavor, që luan rolin e peshës, dhe të filtrimit të ujit në pileta si dhe e mbron hidroizolim nga rrezet e drejtëpërdrejta të diellit.

The complete closed system of flat roof waterproofing is achieved by using metal sheet profiles throughout the perimeter of the building, which are connected to the membranes and the preprepared elements by Evalon. To increase the lifespan of the roofs, the entire waterproofing is covered with a geotextile layer and filled with gravel, which plays the role of weight, water filtration in the drain points, and protects the waterproofing from direct sunlight.

# Ajrues

## Air vents






Prerje,  
Shkalla 1:75

1 Zgarë ajrimi e zinkuar

Section,  
Scale 1:75

1 Galvanized ventilation duct



Ndërtimi i ajruesave mundëson ventilimin dhe ndriçimin natyral të parkimeve nëntokë. Çarjet e ajrimit krijohen në soletat e katit përdhes, mbi hapësirat e shfrytëzuara për parkime të brendshme. Konturet e tyre formohen me parapete beton-arme, ndërsa mbulimi realizohet me zgara të salduara. Përveç kësaj, këto çarje janë të mbuluara me gjelbërim natyral, duke krijuar një pamje tërheqëse dhe të veçantë.

The construction of air vents enables ventilation and natural lighting of underground parking areas. The ventilation openings are created in the ground slabs, above the spaces used for internal parking. Their outlines are formed with reinforced concrete parapets, while the covering is made with welded grids. In addition, these openings are adorned with natural greenery, giving them a unique appearance.


# Muraturë

## Masonry

Muratura është element mbushës dhe ndarës i sipërfaqeve të brendshme dhe nuk ka funksion strukturor. Muratura ndarëse midis apartamenteve dhe hapësirave të përbashkëta është me trashësi 20 cm dhe në të përdoren tulla me dimensione 25x25x20 cm. Për ndarjet brenda një apartamenti përdoren mur tulle me trashësi 10 cm dhe përdoren tulla me dimensione 10x25x25 cm. Duke qenë se tulla është një element i thyeshëm për të siguruar lidhjen e saj me elementet strukturor dhe për të shmangur zhvendosjet jashtë planit të murit në raste të goditjeve nga termetet muri i tullës përforcohet me breza antisizmik në mes të lartësisë së murit dhe kolonçina çdo 6 m për gjatësi të medha si edhe në muret e lira në fasadë. Si brezi antisizmik dhe kolonçina realizohen prej betoni të armuar.

Masonry serves as a filling and dividing element for interior spaces, without a structural function. Partition walls between apartments and shared spaces have a thickness of 20 cm, using bricks with dimensions of 25x25x20 cm. Internal apartment divisions use 10 cm thick walls with bricks measuring 10x25x25 cm. To secure the brick wall against displacement during earthquakes, anti-seismic bands are added at mid-height, and vertical tie beams are installed every 6 m for long walls or free-standing walls on facades. Both anti-seismic bands and tie beams are made of reinforced concrete.





Prerje,  
Shkalla 1:20

- 1 Sistem Kapot
- 2 Strukturë Tra B/A
- 3 Llaç Shtrengues
- 4 Tullë 200x250mm
- 5 Llaç
- 6 Brez Antisizmik

Section,  
Scale 1:20

- 1 ETICS
- 2 Beam B/A
- 3 Tightening Mortar
- 4 Brick 200x250mm
- 5 Mortar
- 6 Antiseismic Reinforced Band



# Penobeton

## Lightweight concrete



Penobeton është një shtresë betoni e lehtësuar me bazë çimento, uji dhe aditiv shkumogjen, i cili përdoret për mbulimin e instalimeve elektrike dhe hidraulike të vendosura në dysheme si dhe për mbushje të lehtësuara para nivelimit. Çimento është lëndë në trajtë pluhuri të përhime, i cili kur njohet me ujë fortësohet. Aditivet që shtohen në penobeton është material i lëngshëm kimik, formulimi i të cilit lejon futjen në beton të mikrofluskave të ajrit të stabilizuara në mënyrë të ekuilibruar.

Lightweight concrete is a lightweight cement-based concrete layer mixed with water and foaming additives, used to cover electrical and hydraulic installations installed in floors, as well as for light filling before leveling. Cement is a powdered material that hardens when mixed with water. The additives in light-weight concrete are chemical liquid materials, allowing the introduction of stabilized air micro-bubbles in the concrete.





Për realizimin e procesit të penobetonit përdoret Çimento me gur gëlqeror CEM II/B-L, 32.5R dhe sasia e aditivit të përdorur është midis intervalit 0.8-2 %. Penobetoni realizohet në një trashësi 4.5 cm dhe në varesi të temperaturës koha e tharjes është 48h.

For the preparation of the lightweight concrete process, Cement CEM II/B-L, 32.5R is used, and the amount of additive is between 0.8-2%. The lightweight concrete has a thickness of 4.5 cm and depending on the temperatures the drying time is 48h.

# Nënshtresë

## Lightweight screed



Shtresë me bazë rërë/çimento e cila aplikohet në ambientet mbitokë për mbulimin e instalimeve elektrike dhe hidraulike të vendosura në dysheme. Kjo shtresë respekton pjerrësinë e përcaktuar nga projekti në varësi të ambientit ku aplikohet, përshtatet me çdo shtresë pasardhëse mbi të, si laminat apo pllaka të ndryshme. Raporti i kërkuar çimento/rërë është 1:3 dhe trashësia e nënshtresës është 45mm. Është një shtresë e fortë dhe kompakte, e cila siguron një bazë të përshtatshme për shtresat përfundimtare të dyshemesë. Për të patur një sipërfaqe të rrafshët dhe horizontale realizohet trajtim i sipërfaqes me helikopter dhe në çdo m<sup>2</sup> kontrollohet kuota me nivelues lazer referuar kuotave të hedhura nga inxhinieri topograf.


A sand/cement-based layer applied above-ground for covering electrical and hydraulic installations placed on the floor. It follows the slope specified in the design, depending on the application area, and adjusts to the floor layers such as laminate or tiles. The required sand/cement ratio is 1:3, and the sub-layer thickness is 45 mm. This layer is strong and compact, providing an appropriate base for the final floor layers. Surface treatment with a helicopter machine ensures a smooth, leveled surface, with laser leveling used for precise height control.

Prerje,  
Shkalla 1:5

- 1 Soletë monolite B\A
- 2 Penobeton
- 3 Instalime Elektrike
- 4 Instalime Hidraulike
- 5 Folie XPS
- 6 Nëshktresa
- 7 Shirit Perimetral

Section,  
Scale 1:5

- 1 Monolithic Floor B/A
- 2 Light weight Screed
- 3 Electric wires
- 4 Hydraulic Installations
- 5 Folie XPS
- 6 Screed
- 7 Perimeter Strip




# Suvatim

## Interior plaster

Suvatim mbushje është lëndë mbushëse me bazë çimento - gëlqere, për nivelimet e mureve të brendshme dhe tavaneve. Suvatim mbushje është i parapërgatitur me rezistencë në shtypje 28 ditore  $\geq 2.5 \text{ N/mm}^2$ . Koha e tharjes së suvatimit është 28 ditë, më pas mund të aplikohet shtresa pasardhëse fino.

Interior plaster is a cement-lime-based filler material for leveling interior walls and ceilings. It is a pre-prepared plaster with a compressive strength of  $\geq 2.5 \text{ N/mm}^2$  after 28 days. The drying time of the plaster is 28 days, after which the finishing layer can be applied.



Prerje,  
Shkalla 1:100

- 1 Soletë Betoni i armuar
- 2 Fasho Suvatimi
- 3 Muraturë Tulle
- 4 Brez Antisizmik, Beton i armuar
- 5 Llaç Çimento
- 6 Suva Fino
- 7 Arkitra Beton i armuar
- 8 Dysheme Laminat
- 9 Rrjetë Përforcuese për këndet

Section,  
Scale 1:100

- 1 Reifrced Concrete Slab
- 2 Plaster Strap
- 3 Brick Masonry
- 4 Antiseismic reinforced band
- 5 Plaster Mortar
- 6 Plaster Finish
- 7 Reifrced Concrete Lintel
- 8 Laminate Floor
- 9 Mesh corner reinforcement



## Fino

### Skim coat

Fino është llaç i thatë, i parapërzier, i hollë, për mure të brendshme mbi suvatim mbushës. Fino e aplikuar është me ngjyre të bardhë dhe e parapërgatitur me punueshmëri të mirë dhe mbulueshmëri të lartë. Aplikohet në trashësi deri në 3 mm. Realizohet për të krijuar një sipërfaqe sa më të rrafshët dhe të njëtrajtëshme për muret e brendshme. Më pas mund të aplikohet shtresa pasardhëse fino.

Smoothing plaster is a dry, pre-mixed, fine plaster for interior walls over the plaster fill. The applied finishing is white and pre-prepared with excellent workability and high coverage. It is applied in thicknesses of up to 3 mm. It is designed to create a smooth and uniform surface for interior walls.





# Bojatisje

## Painting

Bojatisja është shtresa e fundore e cila realizohet në muret e brendshme të një objekti. Boja që përdoret është hidromat me bazë gëlqere, ngjyrë të bardhë për të siguruar një ambient të pastër dhe që lejon qarkullimin e ajrit nga brenda jashtë dhe anasjelltas. Duhet të kryhen një sërë hapash përgatitore si zmerilim dhe stukim të mureve për të arritur sipërfaqe sa më të lëmuara. Aplikimi realizohet me pompë profesionale me dy shtresa e cila aplikohet horizontalisht dhe vertikalisht dhe të lyerja në mënyrë homogjene.

Painting is the final layer which is made on the internal walls of an object. The paint used is hydromat, white color, to ensure a clean environment and that allows air circulation from inside to outside and conversly. A number of preparatory steps must be carried out such as sanding and plastering the walls to achieve the smoothest surface. The application is made with professional pump which is applied horizontally and vertically in two layer and painted in a homogeneous manner.





Prerje,  
Shkalla 1:20


Section,  
Scale 1:20

- 1 Soletë Betoni i armuar 16 cm
- 2 Rrjetë Përforcuese
- 3 Fasho Suvatimi
- 4 Muraturë Tulle
- 5 Kolonë Beton i armuar
- 6 Brez Antisizmik, Beton i armuar
- 7 Llaç suvatimi
- 8 Fino
- 9 Bojatisje

- 1 Reinforced Concrete Slab 16 cm
- 2 Glass Fiber Mesh Reinforcement
- 3 Plaster Strap
- 4 Brick Masonry
- 5 Reinforced Concrete column
- 6 Antiseismic reinforced band
- 7 Plaster Mortar
- 8 Pint Finish
- 9 Paint

# Fasada

## Façades






# Sistem kapotë

## ETICS

Fasadat me kapotë trajtohen me sistemin ETICS me trashësi 100mm të vendosur mbi muraturën 200mm. Leshi i gurit është rezistent kundrejt agjentëve atmosferikë, zjarrit, ndotjes akustike dhe ndotjes së ajrit. Struktura poroze krijon një barrierë termike dhe akustike. Ky system siguron reduktim të konsumit të energjisë deri në 60% dhe siguri më të madhe teknike, zvogëlon urat termike, përmirëson izolimin akustik të mureve, mbron muret nga uji/lagështia dhe është i qëndrueshëm dhe rezistent ndaj dëmtimeve. Kompania që realizon furnizimin e leshit të gurit është kompania Rockwool. Për grafiaton, Kontakt bashkëpunon me kompaninë Keim, lider në botë për bojrat jo organike, duke i dhuruar fasadës ngjyra origjinale që i qëndrojnë kohës.

The thermal insulation of facades is achieved with the ETICS system using rock wool with a thickness of 80 mm, applied over 200 mm masonry. Rock wool is resistant to atmospheric agents, fire, acoustic pollution and air pollution. Its porous structure creates a thermal and acoustic barrier. This system provides a reduction in energy consumption up to 60% and greater technical security, reduces thermal bridges, improves the acoustic insulation of the walls, protects the walls from water/moisture, and is durable and resistant to damage. The company that supplies the insulation material is Rockwool. For the finishing coat, Kontakt collaborates with Keim, the world leader in non-organic paints, giving the facade original colors that stand the test of time.



Prerje,  
Shkalla 1:50

Section,  
Scale 1:50

1 Panel Lesh Guri 8 cm  
2 Profil Pikore Alumini  
3 Upa Fiksuese  
4 Dritare Alumini Termik

5 Rrjetë me fibra qelqi për këndet  
6 Shirit Ekspansiv  
7 Profil Këndor Alumini  
8 Profil W i jashtëm 10 mm

1 Rockwool 8 cm  
2 Water Drip Nose Profile  
3 Fixing Anchors  
4 Thermal aluminum Windows

5 Corner Fiber Glass Mesh  
6 Sealing Joint Tape  
7 Corner Mesh Bracket  
8 Exterior Plaster Sealing Profile  
10 mm


## Lesh guri Rockwool



Leshi i gurit është rezistent ndaj agjentëve atmosferikë, zjarrit, ndotjes akustike dhe ajrit. Struktura poroze ofron izolim termik dhe akustik, ndërsa pllaket janë të padjegshme dhe nuk përhapin flakë.

Rock wool is resistant to weather, fire, acoustic, and air pollution. Its porous structure provides thermal and acoustic insulation. The insulating boards are non-combustible and do not spread flames in case of fire.

## Upa Dowels



Ngjitja e leshit të gurit me murin realizohet me kolla ngjitëse dhe forcohet me upa me kapje mekanike. Vendosja e upave bëhet sipas skemës së miratuar.

The installation of rock wool on the wall is achieved using adhesive compounds and reinforced with mechanical anchors. The placement of anchors follows the approved scheme.

## Profil Profiles



Profilet Protektor që përdoren në sistemin ETICS janë të bërë nga PVC dhe janë të përforcuar me rrjetë xhami. Tipet e profileve përfshijnë profile këndore, pikore, dhe profile ngjitëse midis dritarave të aluminit me termoizolim.

The Protektor profiles that are used in ETICS system are made from PVC and reinforced with fiberglass mesh. The types of profiles include corner profiles, edge profiles, and adhesive profiles between the aluminum windows with thermal insulation.

## Suvatim Plastering




Suvatimi i jashtëm i fasadave të termoizoluara me lesh guri realizohet me materiale të kompanisë gjermane Keim, si KEIM BRILIANTPUTZ dhe KEIM STRUCASOL.

The external plastering of thermally insulated facades with stone wool is done using materials from the German company Keim, such as KEIM BRILIANTPUTZ and KEIM STRUCASOL.

# Dritare

## Windows




Prerje,  
Shkalla 1:15

- 1 Sistem Kapotë 10 cm
- 2 Tra Beton i Armuar
- 3 Arkitra Beton i Armuar
- 4 Kutë Grile Plastike
- 5 Sistem Kapotë 7 cm
- 6 Profil i Sipërm Alumin Termik
- 7 Dopolio Xham, me shtresë Low-e
- 8 Pofil i Mesit Alumin Termik
- 9 Davançal Alumin 5%
- 10 Prag Beton i Armuar

Section,  
Scale 1:15

- 1 ETICS System 10 cm
- 2 Reinforced Concrete Beam
- 3 Reinforced Concrete Lintel
- 4 Plastic Roller Shutter Box
- 5 ETICS System 7 cm
- 6 Top Thermic Aluminium Profile
- 7 Double Glazing, Low-e coated
- 8 Middle Thermic Aluminium Profile
- 9 Aluminium Window Sill 5%
- 10 Reinforced Concrete Sill



Ne i kushtojmë vëmendje kursimit të energjisë dhe reduktimit të humbjeve termike në ndërtim. Dritaret në projektet tona janë alumini termik me gjerësi 100 mm, dy xhama dhe dhomë ajri 16 mm, ideale për klimën mesdhetare të Shqipërisë. Fletët e grilave janë prej alumini, ndërsa kutia është plastike me termoizolim, e cila lehtësohet për mirëmbajtje nga brenda apartamentit. Vlera e izolimit të profilit duhet të jetë  $U_f = 1.9 - 2.4 \text{ W/m}^2\text{K}$  dhe  $U_g = 1.1 \text{ W/m}^2\text{K}$ . Ngjyra e brendshme e profilit është e bardhë, ndërsa jashtë ofrohet një gamë prej 17 ngjyrash sipas projektit arkitektonik. Dritaret termike që përdorim kanë 25% efikasitet më shumë se sistemet tradicionale, me vlerën totale të izolimit  $U_w = 1.3 \text{ W/m}^2\text{K}$ . Dhoma e ajrit ofron një barrierë të shkëlqyer izoluese dhe redukton kondensimin. Pas përfundimit të montimit të të gjitha elementëve dritare, grila, xhama, davancial dhe termoizolim të fasadës realizohen prova uji dhe matje të performancës termike të sistemit.

We pay attention to the energy efficiency and reducing thermal losses in construction. The windows in our projects are thermal break aluminum profiles with a width of 100 mm, double glazing, and a 16 mm air chamber, making them ideal for the Mediterranean climate of Albania. The roller shutter slats are made of aluminum, while the box is plastic with thermal insulation, allowing for easy maintenance from inside the apartment. The insulation value of the frame should be  $U_f = 1.9 - 2.4 \text{ W/m}^2\text{K}$  and for the glass  $U_g = 1.1 \text{ W/m}^2\text{K}$ . The interior profile color is white, while the exterior is available in a range of 17 colors as specified in the architectural design. The thermal windows we use have 25% greater efficiency than traditional systems, with a total insulation value of  $U_w = 1.3 \text{ W/m}^2\text{K}$ . The air chamber provides excellent insulation and reduces condensation. After the installation of all elements windows, shutters, glass, frames, and facade thermal insulation water tests and measurements of the system's thermal performance are conducted.




Prerje,  
Shkalla 1:40

- 1 Soletë monolite B/A
- 2 Tullë 200x250mm
- 3 Llaç
- 4 Arkitra B/A
- 5 Dritare Alumini Termik
- 6 Brez antisizmik

Section,  
Scale 1:40

- 1 Monolithic Slab
- 2 Brick 200x250mm
- 3 Mortar
- 4 Prefab Lintel
- 5 Aluminium Window
- 6 Antiseismic Reinforced Band




# Grilë

## Roller Shutter

Grila është një aksesor i rëndësishëm për dritaret në vendet e mesdheut. Ndhmon ne kontrollin e ndriçimit në apartamente dhe zvogëlon humbjet e energjisë. Kutitë e grilave dhe fletët e grilës së aluminit, të mbushura me material termoizolues, eliminonjë problemin e urave termike dhe lagështisë në pjesën e brendshme të kornizës. Me këtë eliminohet dhe rreziku i mykut dhe kondensimit. Koeficienti i përcjellshmërisë termike është  $U_f = 2,1 \text{ W/m}^2\text{K}$ . Kutia e grilës është alumini, me ngjyrë të bardhë RAL 9003. Kutia e grilës është e aksesueshme nga brenda apartamentit. Udhëzuesit e grilës janë alumini dhe të fshehur në kapotë. Fletët e grilës kanë ngjyrë të njëjtë me profilet e dritareve.

The shutter is an important accessory for windows in Mediterranean countries. It helps to control lighting in apartments and reduces energy losses. Shutter boxes and aluminum shutter sheets, filled with heat-insulating material, eliminate the problem of thermal and moisture bridges in the interior of the frame. This also eliminates the risk of mold and condensation. The thermal conductivity coefficient is  $U_f = 2.1 \text{ W/m}^2\text{K}$ . The shutter box is aluminum, colored white RAL 9003. The shutter box is accessible from inside of the apartment. The shutter guides are aluminum and hidden in the ETICS facade system. The shutter sheets have the same color as the window profiles.



Prerje,  
Shkalla 1:6

- 1 Sistem Kapotë
- 2 Profil i Brendshëm W
- 3 Arkitra Beton i Armuar
- 4 Shkumë Shtrënguese
- 5 Kuti Grile Plastike
- 6 Profil Pikore Alumini
- 7 Profil i Jashtëm W
- 8 Grilë me fletë Alumini me termoizolim
- 9 Udhëzues Grile prej Alumini
- 10 Doppio Xham, i veshur me shtresë Low-e

Section,  
Scale 1:6

- 1 ETICS System
- 2 Interior Plaster Sealing Profile W
- 3 Reinforced Concrete Lintel
- 4 Sealing Foam
- 5 Plastic Roller Shutter Box
- 6 Water Drip Aluminium Profile
- 7 Exterior Plaster Sealing Profile W
- 8 Insulated Aluminium Shutter
- 9 Aluminium Guiding Rail
- 10 Double Glazing, Low-e coated



# Davancial

## Window sills


Dritarja si element i fasades është në kontakt midis ambientit të jashtëm dhe apartamentit. Për këtë arsye tregohet kujdes në detajimin dhe projektimin e elementeve të një dritareje, ku bën pjesë dhe davanciali. Vendosja e davancialit mundëson drenazhimin e ujit, duke e larguar nga dritarja. Mbyllja e poshtme me davancale alumini të ekstruduar Gutmann dhe aksesoret përkates rrit sigurinë e dritares. Montimi i davancaleve siguron mbrojtjen e murit poshtë nga uji dhe realizohet pak i pjerrët në mënyrë që uji të mund të rrjedhë. Davancalet Gutmann janë prej alumini, gjë që e bën të lehtë instalimin e tyre. Është gjithashtu rezistent ndaj faktorëve të jashtëm si rrezet e diellit, shiu i dendur, era dhe papastërtitë. Kompania Guttman, e specializuar në prodhimin e davancaleve, siguron dhe të gjithë aksesoret, si kllapat anësore, shiritin e kontaktit, vidat, mbajtëset përforcuese, mbi kllapat për pushimin e kapotës, duke ofruar një paketë të plotë shumë të sigurt për largimin e ujrave nga dritarja dhe fasada.

The window, as an element of the facade, is in contact between the external environment and the interior part of the apartment. For this reason, care is taken in detailing and designing the components of a window, including the window sill.

The installation of the sill allows for water to drain away from the window. The bottom closure with extruded aluminum sills from Gutmann and the corresponding accessories enhances the window's security.

Installing the sills protects the wall below from water and is done with a slight slope to allow water to flow away. Gutmann sills are made of aluminum, making installation easy. They are also resistant to external factors such as sunlight, heavy rain, wind, and dirt.

Gutmann, a company highly specialized in the production of sills, also provides all the necessary accessories, such as side brackets, contact strips, screws, reinforcing supports, and caps for etics termination, offering a complete and very safe package for water drainage from windows and facades.




Prekje,  
Shkalla 1:10

- 1 Grafiato
- 2 Profil PK, 34 mm
- 3 Kllapa BF
- 4 Shirit Ekspansiv
- 5 Vida me kapuç
- 6 Davancial Alumini


Section,  
Scale 1:10

- 1 Exterior Plaster
- 2 PK Profile, 34 mm
- 3 BF Sliding Closers
- 4 Sealing Tape
- 5 Screws with cap
- 6 Aluminium Sill



Prerje A-A,  
Shkalla 1:5

Section A-A,  
Scale 1:5



Prerje B-B,  
Shkalla 1:5

Section B-B,  
Scale 1:5

Prerje,  
Shkalla 1:10


Section,  
Scale 1:10

- 1 Grafiato
- 2 Shirit Ekspansiv
- 3 Kllapa BF
- 4 Profil PK, 34 mm
- 5 Davancal Alumini
- 6 Termoizolim Lesh Guri
- 7 Vida me kapuç

- 1 Exterior Plaster
- 2 Sealing Tape
- 3 BF Sliding Closers
- 4 PK Profiles, 34 mm
- 5 Aluminium Sill
- 6 Rockwool Insulation
- 7 Screws with cap

# Parapet xhami

## Glass railing



Prerje,  
Shkalla 1:20

- 1 Profil i sipërm, Korimano
- 2 Doppio Xham i laminuar
- 3 Profil i poshtëm
- 4 Pjastër metalike për fiksion parapeti

Section,  
Scale 1:20

- 1 Top Profile, Glass Railing
- 2 Double laminated glass
- 3 Bottom Profile
- 4 Metal plate for fixing

Parapetet e xhamit në llozha të objekteve të banimit janë të bërë me profile alumini të sistemit të ftohtë, duke pasur ngjyrën e njëjtë si dritaret. Xhami është 5+5 mm i temperuar, që ofron siguri dhe qëndrueshmëri. Këto parapete janë shumë estetike dhe kontribuojnë në pamjen moderne të fasadave të objekteve, duke siguruar një ndjesi hapësire dhe dritë në llozha. Ato përmirësojnë gjithashtu funksionalitetin e hapësirave të jashtme.

The glass parapets in the balconies of residential buildings are made with cold system aluminum profiles, matching the color of the windows. The glass is 5+5 mm tempered, providing safety and durability. These parapets are highly aesthetic and contribute to the modern appearance of the building facades, ensuring a sense of space and light in the balconies. They also enhance the functionality of the outdoor areas.




## Parapet kangjella

### Railing



Parapetet e llozhave me profile metalike janë të galvanizuara, duke siguruar qëndrueshmëri dhe rezistencë ndaj korrozionit. Montimi i tyre bëhet anash në elementët e betonit të armuar, duke ofruar mbrojtje për objektin nga pikat e dobëta, siç është infiltrimi i ujit në fasadë. Këto parapete kontribuojnë në sigurinë e llozhave dhe ndihmojnë në ruajtjen e integritetit të strukturës, duke garantuar një jetëgjatësi më të madhe për ndërtesat.

The balcony parapets with metal profiles are galvanized, ensuring durability and corrosion resistance. Their installation is done alongside the reinforced concrete elements, providing protection for the building against weak points, such as water infiltration in the facade. These parapets contribute to the safety of the balconies and help maintain the structural integrity, guaranteeing a longer lifespan for the buildings.



# Teknika e Shtëpisë

## Home Appliance






## Derë objekt

### Building entrance door



Dera e hyrjes në ndërtesë është e prodhuar nga alumini termik, duke ruajtur estetikën dhe karakteristikat e ngjashme me dritaret dhe dyert e llozhave. Ajo është e pajisur me një krah hidraulik për mbyllje automatike, që garanton lehtësinë e përdorimit. Dorezat, profilet dhe mekanizmat janë zgjedhur me kujdes për t'u siguruar që të mos dëmtohen nga përdorimi i përditshëm nga të gjithë banorët e ndërtesës, duke garantuar kështu një jetëgjatësi dhe funksionalitet të lartë.

The entrance door to the building is made of thermal aluminum, maintaining the aesthetic and characteristics similar to the windows and doors of the balconies. It is equipped with a hydraulic arm for automatic closing, ensuring ease of use. The handles, profiles, and mechanisms are carefully selected to ensure they are not damaged by everyday use by all the residents of the building, thereby guaranteeing high durability and functionality.



Prerje,  
Shkalla 1: 20

- 1 Strukturë Tra B/A
- 2 Sistem kapotë
- 3 Arkitra beton i Armuar B/A
- 4 Profil i sipërm Alumini
- 5 Profil i mesit Alumini
- 6 Profil i poshtëm Alumini
- 7 Prag betoni B/A
- 8 Prag mermeri
- 9 Shtresat e trotuarit

Section,  
Scale 1: 20

- 1 Beam B/A
- 2 ETICS
- 3 Prefab lintel B/A
- 4 Top entrance door frame
- 5 Middle entrance door frame
- 6 Bottom entrance door frame
- 7 Concrete sill B/A
- 8 Marble sill
- 9 Side walk


## Derë e jashtme

### External door

Dyert e jashtme janë të realizuara me profile metalike dhe kanë një sipërfaqe antigërvishëse, të mbushura me material termoizolues që siguron izolim të shkëlqyer termik. Ngjyra e dyerve është e bardhë, duke u harmonizuar me dizajnin e brendshëm të shkallës. Profilet e përdorura në dyert e hyrjes përmbushin standardet më të larta të izolimit termik, falë cilësisë së materialeve dhe mbushjes me material termoizolues. Dera e jashtme është e pajisur me dorezë, çelës sigurie dhe sy magjik për mbrojtje shtesë.

The exterior doors are made from metal profiles and feature a scratch-resistant surface, filled with rock wool which provides excellent thermal insulation. The doors are white, harmonizing with the interior design of the staircase. The profiles used in the entrance doors meet the highest standards of thermal insulation, thanks to the quality of the materials and the insulation filling. The exterior door is equipped with a handle, a security key, and a peephole for added protection.





## Derë e brendshme

### Interior door

Dyert e brendshme janë dyer druri të firmës gjermane LEBO, të cilat montohen në ambientet e brendshme të apartamentit, duke sjellë elegancë në interiorin e saj. Panelet e drurit mbushen në brendësi me mdf me carje cilindrike. Dimensionet variojnë sipas ambientit, ndërsa ngjyra e bardhë dhe pamja e thjeshtë e bëjnë derën lehtësisht të përshtatshme me interierin, si dhe më të thjeshtë për t'u mirëmbajtur. Këto dyer janë të forta, rezistente ndaj përdorimit të përditëshëm. Kasa e derës përbëhet nga i njëjti material si sipërfaqja. Sipas standartit DIN18101, fleta e derës ka trashësi 40mm dhe kthehet në tre anë me dimensione 13mmx25.5mm.

The interior doors are wooden doors made by the German company LEBO, installed in the living spaces of the apartment, bringing elegance to its interior. The wooden panels are filled with MDF featuring cylindrical grooves. Dimensions vary according to the space, while the white color and simple design make the door easily compatible with the interior and easier to maintain. These doors are sturdy and resistant to daily use. The door frame is made from the same material as the surface. According to the DIN18101 standard, the door leaf has a thickness of 40mm and is framed on three sides with dimensions of 13mm x 25.5mm.






Prerje,  
Shkalla 1:20

- 1 Fashatura e derës se blinduar
- 2 Kanata e derës
- 3 Mentasha
- 4 Syri magjik
- 5 Dorezë dekorative
- 6 Dysheme Laminat

Section,  
Scale 1:20

- 1 Stel frame door
- 2 Door leaf
- 3 Steel hinge
- 4 Magic eye
- 5 Decorative handle
- 6 Laminate floor



# Ashensor

## Elevators

Ashensorët e instaluar në çdo shkallë të objekteve të banimit janë modele Schindler 3000, të dizajnuara për lëvizjen vertikale të njerëzve. Këta ashensorë kanë kapacitet 625 kg, duke mbështetur deri në 8 persona dhe një shpejtësi prej 1 m/s.

The elevators installed on each floor of the residential buildings are Schindler 3000 models, designed for the vertical movement of people. These elevators have a capacity of 625 kg, supporting up to 8 people, and a speed of 1 m/s.




### Detajet e Kabinës:

Rifinitura e Mureve: Colorado silver (Laminate Glossy), që ofron një pamje moderne dhe elegante.  
Rifinitura e Dyerve të Kateve: RAL7040 (Window Gray), që harmonizohet me mjedisin përreth.  
Rifinitura e Tavanit: Painted steel R9006 (white aluminium) për një ndjesi hapësire.

### Cabin Details:

Wall Finish: Colorado silver (Laminate Glossy), providing a modern and elegant appearance.  
Floor Door Finish: RAL7040 (Window Gray), harmonizing with the surrounding environment.  
Ceiling Finish: Painted steel R9006 (white aluminium) for a spacious feel.



Prerje,  
Shkalla 1:30

- 1 Soletë Monolite B/A
- 2 Hidro-Termo Izolim Tarraca
- 3 Mur i përforcuar B/A
- 4 Kavo STM
- 5 Dera e ashensorit
- 6 Ashensori

Section,  
Scale 1:30

- 1 Monolithic Slab B/A
- 2 Roof Hydro-Thermo Insulation
- 3 Reinforced concrete wall B/A
- 4 STM cable
- 5 Elevator door
- 6 Elevator



**Dyshemeja:** E bërë nga kuarç, që siguron qëndrueshmëri dhe estetike.

**Ndricimi:** Led line, i cili ofron dritë të mjaftueshme dhe efikase.

**Korimano:** I drejtpërdrejtë (jo i harkuar), linear, për një ndihmë më të lehtë gjatë përdorimit.

**Pasqyra:** E instaluar brenda kabinës, duke mbuluar të gjithë lartësinë për një efekt hapësire.

**Ventilimi:** Natyral, përmes dy çarjeve në kabinë, për ajrosje të mirë.

**Display:** Opsione Duplex (i përbashkët) dhe Simplex (brenda kabinës), të përcaktuara sipas skicave të bashkëngjitura.

Ky model ashensori ofron një kombinim të përsosur të komoditetit, estetikës dhe funksionalitetit për çdo ndërtesë banimi.

**Flooring:** Made of quartz, ensuring durability and aesthetics.

**Lighting:** LED line, offering sufficient and efficient illumination.

**Handrail:** Straight (not curved), linear, for easier use.

**Mirror:** Installed inside the cabin, covering the entire height for a spacious effect.

**Ventilation:** Natural, through two openings in the cabin for good air circulation.

**Display:** Options for Duplex (common) and Simplex (inside the cabin), specified according to the attached sketches.

This elevator model provides a perfect combination of comfort, aesthetics, and functionality for any residential building.


# Kangjella në shkallë

## Stair rails



Kangjellat në shkallë janë të dizajnuara nga departamenti i arkitekturës. Ato kanë rëndësi për levizjen e sigurtë të banorëve nga kati në kat. Staf i Kontakt, i krijon me shumë kujdes me qëllim që shkallët metalike të kenë një identitet unik. Janë të punuara në mënyrë artizanale duke i konceptuar si instalacion brenda kafazit të shkallës. Qëllimi ynë është të ruajmë funksionalitetin duke u ofruar gjithashtu banorëve diçka ndryshe nga ajo që ofron tregu të prodhuar në masë.

The staircase railings are designed by the architecture department. They are essential for the safe movement of residents from floor to floor. The team at Kontakt creates them with great care, ensuring that the metal railings have a unique identity. They are handcrafted, envisioned as an installation within the staircase enclosure. Our goal is to maintain functionality while also providing residents with something different from what the market offers in a mass-produced manner.



Prerje,  
Shkalla 1:30

- 1 Soletë monolite B/A
- 2 Shkalla
- 3 Profil tubolar
- 4 Rrjetë metalike
- 5 Pjastër për fiksime dhe bulona


Section,  
Scale 1:30

- 1 Monolithic slab B/A
- 2 Stair
- 3 Tubular profile
- 4 Metallic mesh
- 5 Fixing plate and bolts



# Tualet dhe llozha hidroizolim

## The waterproofing of bathrooms and loggias



Prerje,  
Shkalla 1:20

- 1 Mur tualeti 100 mm
- 2 Soletë monolite B/A
- 3 Dysheme tualeti
- 4 Hidroizolim bikomponent
- 5 Pileta


Section,  
Scale 1:20

- 1 Monolithic slab 100 mm
- 2 Monolithic slab B/A
- 3 Toilet floor
- 4 Two component waterproofing
- 5 Drain point



Hidroizolimi i tualeteve dhe llozhave realizohet me materiale dy komponent të Ardex, si Ardex 8+9L, Primer P51 dhe shirita perforcues SK-12 për këndet. Procesi fillon me përgatitjen e kujdesshme të sipërfaqeve që do të hidroizolohen, ku nivelohet sipërfaqja dhe hiqen pluhurat. Më pas, trajtohen këndet dhe aplikohet një shtresë e lëngshme me një furçë.

The waterproofing of bathrooms and balconies is carried out using two-component materials from Ardex, such as Ardex 8+9L, Primer P51, and SK-12 reinforcing tape for corners. The process begins with careful preparation of the surfaces to be waterproofed, where the area is leveled and dust is removed. Next, the corners are handled, and a liquid layer is applied with a brush.



Prerje,  
Shkalla 1:20

- 1 Soletë monolite B/A
- 2 Dysheme llozhe
- 3 Shirit ngjites
- 4 Hidroizolim bikomponent
- 5 Plintues pllake

Section,  
Scale 1:20

- 1 Monolithic slab B/A
- 2 Loggia floor
- 3 Sealing tape
- 4 Two component waterproofing
- 5 Skirting tile



48 orë pas tharjes, realizohet testi i ujit: sipërfaqja e hidroizoluar mbushet me ujë dhe lëshohet për 24 orë. Pas kalimit të suksesshëm të testit, fillon shtrimi i pllakave. Kjo procedurë siguron një mbrojtje efikase ndaj lagështirës dhe ujit, duke garantuar qëndrueshmëri dhe jetëgjatësi për hapësirat e tualeteve dhe llozhave.

After 48 hours of drying, a water test is conducted: the waterproofed surface is filled with water and left for 24 hours. Upon successful completion of the test, tile installation begins. This procedure ensures effective protection against moisture and water, guaranteeing durability and longevity for the bathroom and balcony areas.


# Pllakë

## Tiles

Shtrimi me pllaka porcelani realizohet për nyjet higjenesitare. Ngjyra e pllakave kombinohet lehtësisht me interiorin e tualeteve. Këto pllaka mirëmbahen lehtësisht duke siguruar jetëgjatësi më të lartë për hapësirat e tualeteve. Veshja me pllaka realizohet deri në gjysmën e lartësisë së tualetit, përveç pjesës së dushit ku veshja realizohet në të gjithë lartësinë e tualetit. Pllakat janë gres porcelan me përmasa 60x120cm dhe trashësi 8mm. Shtrimi me pllaka në nyjet higjenesantire realizohet me një pjerrësi prej 0.5% për të mundësuar orientimin e ujrave drejt piletës. Materiali i përdorur ka një koeficient fërkimi të ulët sipas standarteve të kërkuara, duke i bërë ambientet e tualeteve më të sigurt.

The final layer of a bathroom floor consists of porcelain tiles. The color of the tiles is easily combined with the interior of the bathroom. These tiles are easy to maintain, ensuring a longer lifespan.

On the bathroom walls, the tiles are placed up to half of their height, except for the shower area where the tiles cover the entire height of the wall. The tiles are porcelain stoneware with dimensions of 60x120cm and 8mm thickness. Tiles are placed with a 0.5% slope to enable the orientation of the water towards the drain. In order to make the bathrooms safer, the tiles we use have a low coefficient of friction in accordance with the required standards.





Prerje,  
Shkalla 1:20

- 1 Sistem kapot 70 mm
- 2 Muraturë 200 mm
- 3 Pileta dushi - PLAN
- 4 Dritarja standarte - PLAN
- 5 Dysheme Tualete - PLAN
- 6 Pileta - PLAN

Section,  
Scale 1:20

- 1 ETICS 70 mm
- 2 Masonry 200 mm
- 3 Drain point shower - PLAN
- 4 Standart window - PLAN
- 5 Toilet floor - PLAN
- 6 Drain point - PLAN



# Laminat

## Laminate

Punimet e shtresave në dysheme finalizohen me nënshtresë 3mm dhe laminat me trashësi 8mm AC4 që përdoret për ambiente shtëpiake. Plintusi ka ngjyrë të bardhë dhe lartësi 6cm. Laminati është cilësor për zona me trafik të lartë njerëzor, ku njerëzit janë aktive dhe në lëvizje. Detaji i zgjedhur ofron dysheme të ngrohta dhe mirëmbajtje të thjeshtë, duke siguruar jetëgjatësi të lartë. Materiali i përzgjedhur AC4 është më i qëndrueshëm, rezistent ndaj konsumit, gërryerjes, gërvishjes dhe zbehjes së ngjyrës, duke qenë se do të jetë herë pas herë i ekspozuar ndaj rrezeve të diellit.


The final layer of the floor consists of a 3mm underlay and 8mm AC4 laminate used for indoor environments. The skirting board is white in color and 6cm high. The laminate satisfies the required quality for areas with heavy foot traffic, where people are active and on the move. The selected detail offers warm floors and simple maintenance, ensuring a long life. The selected AC4 material is more durable, resistant to wear, abrasion, scratching and color fading, as it will be occasionally exposed to sunlight.

Prerje,  
Shkalla 1:5

- 1 Muraturë 200mm
- 2 Plintues druri
- 3 Dysheme laminat
- 4 Soletë monolite

Section,  
Scale 1:5

- 1 Masonry 200mm
- 2 Wood skirting
- 3 Laminate floor
- 4 Monolithic slab






# Kuti poste

## Mail Box

Kutite e postes janë të vendosura në koridorin e hyrjes së objektit, duke ofruar një mënyrë të organizuar për dorëzimin e korrespondencës. Çdo njësi ka kutinë e saj postare, e cila është e emërtuar me kodin e njësisë dhe emrin e banorit. Kutite e postes Knobloh janë metalike, duke garantuar qëndrueshmëri dhe siguri për dokumentet dhe paketat e banorëve, gjithashtu duke kontribuar në pamjen estetike të hapësirës së përbashkët.

The mailboxes are located in the entrance hallway of the building, providing an organized way for delivering correspondence. Each unit has its own mailbox, labeled with the unit code and the resident's name. Knobloch mailboxes are made of metal, ensuring durability and security for residents' documents and packages, while also contributing to the aesthetic appeal of the shared space.



Prerje,  
Shkalla 1:40

Section,  
Scale 1:40


1 Kuti poste  
2 Dysheme pllake  
3 Soletë monolite B/A

1 Mail box  
2 Tiles floor  
3 Monolithic slab




# Portë parkim

## Parking door



Portat e hyrjes në parkimin nën tokë kanë një mekanizëm hapjeje vertikale dhe komandohen me pult. Çdo banor që posedon një vend parkimi nën tokë pajiset me këtë pult për të siguruar një menaxhim efikas të hyrjeve dhe daljeve. Ky sistem lehtëson qarkullimin brenda parkimit dhe garanton një kontroll më të mirë mbi aksesin, duke rritur sigurinë dhe komoditetin për të gjithë banorët.

The entrance gates to the underground parking area have a vertical opening mechanism and are operated by a remote control. Each resident who has an underground parking space is provided with this remote to ensure efficient management of entries and exits. This system facilitates circulation within the parking area and ensures better control over accessibility, enhancing security and convenience for all residents.



# Vijëzim parkimi

## Parking area signs

Vijëzimi horizontal i postit të parkimit realizohet me bojë dy komponentësh me fosfor për një dukshmëri më të lartë. Piketimi bëhet sipas projektit, duke siguruar saktësi në vendosjen e vijave. Vijëzimi realizohet me viza të pandërprera për çdo vend parkimi dhe përfshin shënimin e kodit të parkimit. Gjithashtu, vendosen sinjalizimet horizontale për drejtimin e lëvizjes, daljet dhe zonat e kalimit të këmbësorëve, duke garantuar një organizim të qartë dhe të sigurt të hapësirës.

The horizontal marking of parking spaces is done with two-component paint with phosphorescence for higher visibility. The layout is created according to the project, ensuring accuracy in the lines placement. Marking is carried out with continuous lines for each parking space and includes the designation of the parking code. Additionally, horizontal signals are installed for traffic direction, exits, and pedestrian crossing areas, ensuring a clear and safe organization of the space.






Prerje,  
Shkalla 1:200

Section,  
Scale 1:200

- 1 Numër parkimi
- 2 Vije e vazhduar
- 3 Vije e ndërprerë
- 4 Shigjetë orientuese
- 5 Vendkalim këmbësorësh

- 1 Parking number
- 2 Continuous line
- 3 Dashed line
- 4 Direction arrow
- 5 Crosswalk




# Tabelizim objekt

## Directional signs

Sinjalistika orientuese në objekt është e plotësuar në çdo kat, duke treguar numrin e njësisë, numrin e katit dhe drejtimin e lëvizjes për dalje. Ajo përfshin gjithashtu tabela detyruese për mbajtjen e pastërtisë, qetësisë dhe ndalimin e duhanpirjes. Projekti i sinjalistikës, përfshirë shkrimin, tabelat dhe ngjyrat e përdorura, është menduar me kujdes nga departamenti i dizajnit të Kontakt, duke siguruar një informacion të qartë dhe tërheqës për të gjithë banorët.

The orientation signage in the building is completed on every floor, indicating the unit numbers, floor numbers, and the direction for exits. It also includes mandatory signs for maintaining cleanliness, quiet, and prohibiting smoking. The signage project, including the writing, signs, and colors used, has been carefully designed by the design department of Kontakt, ensuring clear and appealing information for all residents.








Prerje,  
Shkalla 1:5

Section,  
Scale 1:5


- 1 Mbani Pastër
- 2 Ndalohet Duhani
- 3 Shkallë
- 4 Ashensori

- 1 Keep Clean
- 2 No Smoking
- 3 Stairs
- 4 Elevator



# Elektrike

Electrical





# Rrufepritës


## Lightningrod

Prerje,  
Shkalla 1: 10

Section,  
Scale 1: 10

1 Rruferpritës  
2 Izolues për rruferpitës  
3 Mbushje me zhavorr  
4 Shtresë Hidroizoluese Evalon  
5 Termoizolim Lesh Guri 10 cm

1 Lightningrod  
2 Steeve for penetrations  
3 Gravel filling  
4 Evalon waterproofing layer  
6 Rockwool insulation 10 cm



Të gjitha tarracat e objekteve mbrohen nga shkarkimet atmosferike. Tek të gjitha pajisjet metalike, komponentët më të gjatë se 1m janë të lidhur me sistemin e mbrojtjes nga rrufetë. Në çdo objekt ka shtiza të instaluara përgjatë parapetit por dhe tek pjesa e kupolës (pjesa më e lartë). Shiriti i rruferpitësit vendoset brenda kolonave të betonit duke mos prishur pamjen e fasadave. Për arritjen e vlerës së rezistencës së tokëzimit  $<10\Omega$ , instalohen elektrodën e tokëzimit për çdo shirit rruferpitësi. Shiriti lidhet me elektrodën brenda pushtave elektrike me izolatorë që lehtësojnë matjen e rregullt të rezistencës së tokëzimit.


All the roofs of the buildings are protected from atmospheric emissions. In all metal equipment, components longer than 1m are connected to the lightning protection system. In each building, there are spears installed along the parapet but also on the part of the dome (the highest part). The lightning rod is placed inside the concrete columns without spoiling the appearance of the facades. In order to achieve the grounding resistance value  $<10\Omega$ , grounding electrodes are installed for each lightning rod. The strip is connected to the electrode inside the electrical wells with insulators that facilitate the regular measurement of earth resistance.

# Tokëzim

## Earthing

Për një sistem elektrik sa më të sigurtë realizohet tokëzimi mbrojtës në kabinë elektrike dhe pranë çdo grupi me matës elektrik. Tokëzimi realizohet me elektroda të zinkuara me gjatësi 1.5 m dhe linja e tyre bëhet me precjellës të zhveshur bakri  $S=95 \text{ mm}^2$ . Brenda kabinës elektrike realizohet një kontur prerimetral me percjellës zinku ku tokëzohen të gjitha pasijet elektrike dhe pjesët metalike të kabinës. Tokëzimi i bokseve të matjes realizohet sa më afër bokseve. Vlera e rezistencës së tokëzimit duhet të jetë  $<4\Omega$ . Në rast se kjo vlerë nuk arrihet shtohen elektroda ose realizohet përmirësim i dheut duke e përzier me qymyr dhe kripë.

For an electrical system that is as safe as possible, earthing of the protection is carried out in the electrical cabinet and near each group with electrical measurements. Earthing is done with galvanized electrodes with a length of 1.5 m and their line is made with bare copper conductor  $S=95 \text{ mm}^2$ . Inside the electrical cabin, a pre-metral contour is made with zinc conductors where all the electrical cables and metal parts of the cabin are grounded. The earthing of the measurement boxes is connected as close as possible to the boxes. The earthing resistance value should be  $<4\Omega$ . If this value is not reached, electrodes are added or soil improvement is carried out, mixed with coal and salt.



Prerje, ,  
Shkalla 1: 150

1 Rrufepritës  
2 Pusetë metalike  
3 Elektroda

Section,  
Scale 1: 150

1 Lightningrod  
2 Metallic well  
3 Electrodes

# Kabina Elektrike

## Electrical Cabin

### Transformator


Kabina elektrike është e pajisur me transformatorët e markës së njohur Andeli. Keta transformatorë me grup lidhje Dyn11 kanë nivel tensioni 20/0.4 Kv dhe realizojnë furnizimin me energji elektrike të objektit. Transformatorët e përdorur janë të tipit të thatë për të shmangur rrezikun nga zjarri. Kabina elektrike është e pajisur me sistemin e lajmërimit zanor dhe vizual nëse ka mbinxehje të transformatorëve.

Transformatorët janë të mbyllur me kapakë metalik për mbrojtjen nga fushat elektromagnetike duke imituar Kafazin i Faradeit i cili pengon përhapjen valeve elektromagnetike në ambientin përreth.

### Transformer

The electric cabin is equipped with transformers of the well-known company Andeli. These transformers with Dyn11 connection group have a voltage level of 20/0.4 Kv and supply the facility with electricity.

The transformers used are dry type to avoid fire hazard. The electric cabin is equipped with a sound and visual warning system if there is overheating of the transformers. The transformers are closed with metal caps for protection from electromagnetic fields, imitating the Faraday Cage, which prevents the spread of electromagnetic waves in the surrounding environment.



Prerje,  
Shkalla 1:35


- 1 Ndriçues
- 2 Linja Tensioni i ulët
- 3 Brez Betoni 50 cm
- 4 Linja Tensioni i mesëm
- 5 Transformator
- 6 Panel Tension i ulët
- 7 Çela
- 8 Rrjetë Metalike

Section,  
Scale 1:35

- 1 Lighting spot
- 2 Low Power line
- 3 Concrete lintel 50 cm
- 4 Medium power line
- 5 Transformer
- 6 Low power panel
- 7 Çela
- 8 Metallic mesh

## Sahat Elektrik

Matësat elektrik janë të grupuar për të gjithë shkallën në një ambient teknik që zakonisht ndodhet në katin -1. Matësat grupohen në një boks metalik me kapacitet 20 matësa dhe një matës bilanci. Pamja ballore e këtij boksi është me xham në për leximin nga faturisti. Matësat për ambientet e shërbimit dhe ambientet e përbashkëta janë 3 fazor ndërsa për apartamentet instalohen matës 1 fazor. Matësat janë inteligjent dhe përveç konsumit realizojnë dhe matje të tensionit, rrymës, frekuencës, data ora etj. Për çdo grup matësish instalohet dhe një matës bilanci i cili mat shumatoren e të gjithë matësive individual. Për çdo shkallë instalohet dhe një matës për ambientet e përbashkëta (ashensor, ndricim shkallë, pompa, ndricim i jashtëm). Komsumi i këtij matësi i përpjetohe te të gjithë banorët e shkallës.



## Çela

Çelat e tensionit të mesëm 20 kv janë të tipit SM6 të kompanisë së njohur Schneider. Shuarja e harkut në dhomën e shkyqjes realizohet me gas SF6 ose vakum. Çelat kanë tension izolimi 24 Kv, rryme nominale 630 A dhe mbrojtje nga lidhjet e shkurtra  $I_{cc}=20$  KA për 1 sekond. Mbrojtja e tyre realizohet me siguresa ose automate të motorizuar sipas rastit. Për çdo kabine elektrike kemi bllokun e çelave i cili përbëhet nga çela e hyrjes, çela e daljes dhe çelat e transformatorëve.

## Electrical Meters

Electric meters are grouped for the entire stair in a technical room that is usually located on the -1st floor. The meters are grouped in a metal box with a capacity of 20 measurements and a balance meter. The front view of this box is glassed in for reading by the accountant. Meters for service rooms and common areas are 3-phase, while 1-phase meters are installed for apartments. Measurements are intelligence and in addition to consumption, they also measure voltage, current, frequency, date and time, etc. For each group of meters, a balance meter is installed, which measures the sum of all individual measurements. One is installed for each level.



## Switchgear

The cells of medium voltage 20 kv are type SM6 of the well-known company Schneider. Extinguishing the arc in the disconnection room is done with SF6 gas or vacuum. The cells have insulation voltage 24 Kv, nominal current 630 A and protection from short circuits  $I_{cc}=20$  KA for 1 second. Their protection is realized with fuses or motorized automata as the case may be. For each electric cabinet, we have the block of cells, which consisted of the input cell, the output cell and the transformer cells.


# Instalime elektrike

## Electrical installations

Furnizimi me energji i njësive të shërbimit dhe apartamenteve realizohet me kablllo bakri FG16OR të cilët instalohen në kanalina metalike dhe tuba fleksibel PVC. Kabllot janë kryesisht produkte italiane nga kompani të njohura si General Cavi, Icel, Irce, La Triveneta Cavi etj. Linja e furnizimit për ambientet e shërbimit është 5x6mm<sup>2</sup> dhe për apartamentet 3x6mm<sup>2</sup>. Linjat instalohen pa shkëputje nga matësi elektrik deri tek kuadri elektrik i njësisë.

Për mbrojtjen e linjës nga mbingarkesat dhe qarqet e shkurtër, brenda në boksit të matësave instalohet automat 4P, 32A për ambientet tregtare dhe automat 2P, 25 A për apartamentet.

The energy supply of the service units and apartments is made with FG16OR copper cables, which are installed in metal ducts and flexible PVC pipes. The cables are mainly Italian products from well-known companies such as General Cavi, Icel, Irce, La Triveneta Cavi, etc. The supply line for service rooms is 5x6mm<sup>2</sup> and for apartments 3x6mm<sup>2</sup>. The lines are installed without disconnection from the electrical meter to the electrical frame of the unit. To protect the line from overloads and short circuits, a 4P, 32A automatic switch for commercial premises and a 2P, 25 A automatic switch for apartments are installed inside the metering box.





Prerje,  
Shkalla 1:50


- 1 Panel Elektrik
- 2 Kuti 3M me 1 prizë shuko 16A dhe 1 tapë fallco, H=120 cm (për banakun)
- 3 Kuti 3M me 1 prizë shuko 16A dhe 1 tapë fallco, H=40 cm
- 4 Kuti 4M me 1 prizë shuko 16A dhe 2 priza bivalente 10A, H=150 cm
- 5 Kuti 3M me 1 prizë shuko 16A dhe 1 tapë fallco, H=40 cm (për lavatriçen)
- 6 Kuti 3M me 1 prizë shuko 16A dhe 1 çelës 1P, H=120 cm (për pasqyrën)
- 7 Kuti 3M me 1 prizë shuko 16A dhe 1 tapë fallco, H=160 cm (për boilerin)
- 8 Kuti shpërndarëse Pt 5, H=25 cm
- 9 Dalje fuqisë 400 V per kondicionerin
- 10 Kabëll 3x10 mm + Tub Ø32
- 11 Percjelles 3x4 mm + Tub Ø32

Section,  
Scale 1:50

- 1 Electrical Panel
- 2 Switch Plug , H=120 cm (for kitchen counter)
- 3 Switch Plug, H=40 cm
- 4 Switch Plug 16A , H=150 cm
- 5 Switch Plug 16A, H=40 cm (for washing machine)
- 6 Switch Plug, H=120 cm (for mirror)
- 7 Switch Plug, H=160 cm (for boiler)
- 8 Distribution Box Pt 5, H=25 cm
- 9 Power Output 400 V, for AC
- 10 Cable 3x10 mm + Pipe Ø32
- 11 Conductor 3x4 mm + Pipe Ø32

# Tv, Internet

## Tv, Internet



Prekje,  
Shkalla 1:75

Section,  
Scale 1:75

- 1 Antena
- 2 Amplifikator
- 3 Kutia shpërndarëse e sinjalit

- 4 Kabëll i TV
- 5 Kutia e prizës

- 1 Antenna
- 2 Amplifikation
- 3 Signal Distribution Box

- 4 TV Cable
- 5 Plug Box

Në çdo apartament realizohen instalimet për sinjalin e internetit televizorit. Sinjali tv dhe internet shpërndahet për çdo tv në dhomë ndenje dhe dhomë gjumi. Për shpërndarjen e internetit përdoret kabëll FTP Cat 5 dhe prizë RJ45. Për sinjalin televiziv përdoret kabëll RG6. Në mënyrë që mos të interferojnë me njëra tjetrën linjat e silaleve instalohen në tuba të ndara me linjat elektrike. Antenat e sinjalit televiziv janë individuale për çdo shkallë dhe montohen në taracë pa dëmtuar hidroizolimën e saj. Antenat janë të markës Alfabet dhe shpërndarja në pus teknik realizohet me splitter dhe multiswitch Fracarro. Çdo prizë televizori dhe interneti testohet nëse sinjali arrijt në parametrat e duhur.

In each apartment, installations for internet signal and television are implemented. The TV and internet signals are distributed to each TV in the living room and bedroom. For internet distribution, FTP Cat 5 cables and RJ45 sockets are used. For the television signal, RG6 cables are employed. To prevent interference between the different signal lines, the signal lines are installed in separate conduits away from the electrical lines. The television antennas are individual for each staircase and are mounted on the roof terrace without damaging the waterproofing. The antennas are of the Alfabet brand, and the distribution in the technical shaft is carried out using splitters and multiswitches from Fracarro. Each TV and internet socket is tested to ensure the signal meets the required parameters.



### Fiber Optike

Shpërndarja e internetit në rezidencat tona realizohet me fibër optike. Për shpërndarjen e fibarave optike prashikohet infrastrukturë nëntokësore nga pika e lidhjes deri brenda objekteve. Shpërndarja brenda objekteve realizohet me kanline metalike që instalohen në katet-1 dhe në pus teknik. Për çdo apartament instalohet një fibër optike nga kutia shpërndarëse e apartamentit deri tek kati -1 në obientin teknik. Të gjitha kompanitë e shpërndarjes së internetit mund ta aksesojnë infrastrukturën për instalimin e fibrës optike duke lehtësuar klientët të zgjedhin kompaninë që duan.

### Optical Fiber

The internet distribution in our residences is implemented via fiber optics. The fiber optic distribution is planned with an underground infrastructure from the connection point to the interior of the buildings. The distribution within the buildings is achieved using metallic cable tray installed on the -1 floor and in the technical shaft. For each apartment, a fiber optic line is installed from the distribution box of the apartment to the -1 floor in the technical room. All internet service providers can access the infrastructure for fiber optic installation, allowing customers to choose their preferred provider.

# Fruta elektrike


## Electrical parts

### Automat

Çdo linje elektrike mbrohet nga një automat i vecantë. Automatet e mbrojnë linjën nga mbingarkesat, lidhjen e shkurtëra dhe rrjedhjet me tokën (automate diferencial 30 mA) Automatet janë të gjitha prodhime europiane të markave ABB dhe Schneider. Brenda njësisë automatet që përdoren janë nga 10 deri në 25 Amper, Klasa C, 4.5 kA. Ata grupohen në kuadro elektrik zakonisht 24 modulesh. Automatet në kabinetin elektrike që shërbejnë për furnizimin me energji të objekteve janë të tarueshëm dhe variojnë nga 160A deri në 630A të cilët grupohen në panele metalike jashtë murit.

### Circuit breaker

The electrical line is protected by a dedicated circuit breaker. The circuit breakers protect the line from overloads, short circuits, and leakage currents with a sensitivity of 30 mA (differential circuit breakers). All breakers are European-made products from brands such as ABB and Schneider. Within the units, the circuit breakers used range from 10 to 25 Amperes, Class C, with a breaking capacity of 4.5 kA. They are typically grouped in electrical panels containing 24 modules. The circuit breakers in the electrical cabinet that serve to supply power to the facilities are loadable and vary from 160 A to 630 A, grouped in metallic enclosures mounted on the wall.




### Priza/Çelësa

Përzgjedhja e çelësave dhe prizave bëhet me shumë kujdes duke siguruar një produkt cilësor dhe me disajn elegant. Seritë e përdorura janë zakonisht Vimar neve, Bticino Classia, Abb Chiara. Prizat që përdoren janë "shuko" 2 polare + Toke 16A dhe çelësat e përdorur janë 1 polar 10A përveç bolirit që është 2 polar 16A. Ngjyra e çelësave, prizave dhe kapakëve të tyre është gjithmonë e bardhë. Standarti i përdorur është standarti italian ku prizat shuko janë 2 module dhe çelësat 1 modul. Instalimi i tyre realizohet në kuti plastike brenda murit 3 ose 4 module.

### Switches / Sockets

The selection of switches and sockets is made with great care to ensure a high-quality product with an elegant design. The series commonly used include Vimar Neve, Bticino Classia, and Abb Chiara. The sockets utilized are 2-pole + Ground "Schuko" 16A, while the switches are 1-pole 10A, except for the boiler switch, which is 2-pole 16A. The color of the switches, sockets, and their covers is always white. The standard applied is the Italian standard, where the Schuko sockets are 2 modules and the switches are 1 module. Their installation is carried out in plastic boxes embedded within the wall, accommodating 3 or 4 modules.



### Përcjellës


Përcjellësit elektrik janë elementët bazë për transmetimin e energjisë elektrike. Brenda njësisë të banimit dhe shërbimit përdoren përcjellës bakri FS17 me ngjyra të ndryshme sipas standarteve europiane. Ngjyrat e fazës janë gjithmone gri, kafe, dhe zeze, ngjyra e neutril blu dhe ngjyra e tokës verdhë-jeshile. Përcjellesit e përdorur janë kryesisht podhime italiane. Përcjellesit përdoren vetëm brenda njësisë ndërsa jashtë tyre furnizimet kryesore të apartamenteve dhe objekteve realizohen me kablllo bakri FG16OR16. Instalimi i tyre realizohet në tuba fleksibel dhe kanlina metalike horizontale dhe vertikale. Bashkimi i percjellsave realizohet gjithmonë me kapikorda, klema dhe terminale.

### Conductor

The selection of switches and sockets is made with great care to ensure a high-quality product with an elegant design. The series commonly used include Vimar Neve, Bticino Classia, and Abb Chiara. The sockets utilized are 2-pole + Ground "Schuko" 16A, while the switches are 1-pole 10A, except for the boiler switch, which is 2-pole 16A. The color of the switches, sockets, and their covers is always white. The standard applied is the Italian standard, where the Schuko sockets are 2 modules and the switches are 1 module. Their installation is carried out in plastic boxes embedded within the wall, accommodating 3 or 4 modules.

# Ndriçim

## Lighting



Prerje,  
Shkalla 1:30

- 1 Soletë Monolite B/A
- 2 Ndriçim në korridor
- 3 Muraturë 200 mm
- 4 Brez antisizmik
- 5 Dysheme pllakë

Section,  
Scale 1:30

- 1 Monolithic Slab B/A
- 2 Hallway lighting
- 3 Masonry 200 mm
- 4 Anti-seismic belt
- 5 Tile floor

## Emergjent Emergency



Ndriçuesit emergjent instalohen në ambientet e përbashkëta si korridor apo shkallë, janë të pajisur me bateri të karikueshme që i ndezin ata menjëherë sapo ndërpihet energjia elektrike.

Emergency lights are installed in common areas such as corridors or stairwells, they are equipped with rechargeable batteries that activate immediately upon loss of power.


## Sensor Sensor



Komandimi i ndriçuesëve në ambientet e përbashkëta koridore dhe parkime realizohet me sensor prezence ndërsa komandimi i ndiçuesëve të jashtëm realizohet me sensor muzu.

The control of lighting fixtures in common areas, corridors, and parking spaces is achieved through presence sensors, while the control of outdoor fixtures is managed using twilight sensors.

## Ashensorë Elevator



Në brendësi të kafazit të ashensorit realizohet ndriçimi me ndriçues linear të cilët instalohen të barazlanguar çdo 3 metër nga njëri tjetri. Ndriçuesit janë linear L=120 cm, fuqia 18W temperaturë 6500 K.

Inside the elevator shaft, linear lighting are installed, with fixtures evenly spaced every 3 meters. The linear fixtures are 120 cm in length, have a power rating of 18W, and a color temperature of 6500K.

## Parkim Parking



Ndriçimi i parkimeve realizohet me ndriçues linearë IP65, L=120 cm, 47w, 4000 K. Infrastrukutra me tuba realizohet që në fazë beton armeje ndërsa ndriçuesi instalohet jashtë betonit.

Parking lighting is provided by linear fixtures rated IP65, with a length of 120 cm, a power rating of 47W, and a color temperature of 4000K. The infrastructure, is implemented during the reinforced concrete phase.

## Ndriçim vinç

### Crane lighting

Çdo vinç që instalohet në kantier pajiset me ndriçim që shërben për ndriçimin e kantierit përreth vinçit. Ndriçimi i vinçave është dy llojesh:

The crane installed on the construction site is equipped with lighting designed to illuminate the surrounding area. The lighting for the cranes is of two types:




Ndriçim me shirit led që instalohet në krahun dhe kolonën e vinçit.

Ndriçim me prozhektor ku instalohet një prozhektor në pjesën më të lartë të kolonës së vinçit. Shirti led është hermetik, me temperaturë 4000K dhe fuqi 12W/m. Prozhektorët e instaluar janë të kompanisë Relco tipit Milano LED Sports 3, hermetik me trup metalik me fuqi 1200W dhe temperaturë 4000K.

LED Strip Lighting: This is installed along the arm and the column of the crane. The LED strips are hermetically sealed, with a color temperature of 4000K and a power rating of 12W/m.

Floodlights: A floodlight is mounted at the top of the crane column. The floodlights used are from Relco, model Milano LED Sports 3.



Prerje,  
Shkalla 1:40

- 1 Projektor
- 2 Kabina operuese
- 3 Ndrëhim shirit led

Section,  
Scale 1:40

- 1 Projector
- 2 Operator's cab
- 3 Led strip lighting



# Testime elektrike

## Electric tests

Çdo instalim elektrik përpara se të merret në dorëzim testohet nga inxhinieri përkatës. Për të realizuar testimet përdoren pajisje të çertifikuara të cilat janë brenda standarteve europiane. Testimi garanton që instalimet elektrike janë të sigurta dhe përmbushin standartet e kërkuara. Testimet më të zakonshme janë: matja e rezistencës së tokëzimit, matja e rrymave, matja e tensionit, matja e izolacionit të kabllove, testimi i automateve, testimi dhe matja e sinjaleve. Pajisjet e testimit janë brandet më të famshme si: Fluke, Megger, HT, Pancontrol etj.

Before any electrical installation is handed over, it is tested by the relevant qualified engineer. Certified equipments that complies with European standards are used for the testing procedures. The testing ensures that the electrical installations are safe and meet the required standards. The most common tests include: measurement of grounding resistance, measurement of currents, measurement of voltage, measurement of cable insulation, testing of circuit breakers, and signal testing and measurement. The testing equipments used are from well-known brands such as Fluke, Megger, HT, Pancontrol, etc.



### Testuesi i tokëzimit

Testuesi i tokëzimit është një pajisje që përdoret për të matur dhe kontrolluar lidhjet e tokës në instalimet elektrike. Ajo tregon prezencën e tokëzimit dhe vlerën e tij. Është në formë spine e përshtatshme për t`u futur në prizat shuko.

### Ground Tester

The grounding tester is a device used for measuring and verifying the integrity of grounding connections in electrical installations. It detects the presence of grounding and provides its resistance value. Designed in a plug-in form, it is compatible with Schuko outlets for easy testing.



### Multimetri WURTH

Multimetri është një instrument matës që përdoret për të matur parametra elektrikë si tensioni (V), rryma (A) dhe rezistenca ( $\Omega$ ). Multimetri përdoret për kontrole të shpejta të parametrave elektrikë në kantier. Matja e rrymës realizohet me darë ndërsa tensioni dhe parametrat e tjerë maten me fishat ndihmëse.

### WURTH Multimeter

A multimeter is a measuring instrument used to assess electrical parameters such as voltage (V), current (A), and resistance ( $\Omega$ ). It is commonly used for quick electrical parameter checks on-site. Current measurement is performed using a clamp, while voltage and other parameters are measured using auxiliary probes.



### Circuit Finder

Circuit Finder është një pajisje që përdoret për të identifikuar dhe gjetur automatën që mbrojnë linjën elektrike. Gjithashtu instrumenti realizon testimin e automatit diferencial nga prizat e shërbimit me anë të butonit "RCD 30 mA Test".



### Circuit Finder

A Circuit Finder is a device used to identify and locate the circuit breaker that protects an electrical circuit. Additionally, the instrument performs testing of the residual current circuit breaker (RCCB) from service outlets using the "RCD 30 mA Test" button.

# Mekanike

Mechanical





# Stacion pompa

## Pump station


Për lehtësi shërbimi, në mungesë të kushteve të furnizimit me ujë 24 orë, parashikohet Ambienti Teknik që përfshin rezervën ujore dhe grupet përkatëse të pompimit për impiantin e mbrojtjes nga zjarri dhe për furnizimin me ujë sanitar.

For service convenience, in the absence of a 24-hour water supply, a Technical Room is provided, which includes water reserve and the respective pumping groups for the fire protection system and the sanitary water supply.



Grupi i pompimit përbëhet nga dy grupe pompash: për furnizimin me ujë dhe për sistemin e mbrojtjes kundra zjarrit si edhe nga autoklava. Pompat janë pajisur më kolektorët e thithjes dhe dërgimit, që janë të galvanizuar me veshje shtresë epoxidi. Ato kanë në përbërje gjithashtu flusometër, manometër, valvola ndërprerëse, valvol moskthimi, si dhe panel elektrik komandimi dhe kontrolli, si presostatët e presionit etj.

The pumping group consists of two pump sets: one for the water supply and one for the fire protection system, as well as an autoclave. The pumps are equipped with suction and discharge manifolds, which are galvanized with an epoxy coating. They also include a flow meter, pressure gauge, shut-off valves, check valves, and an electrical control and monitoring panel, including pressure switches, etc.



Prerje,  
Shkalla 1:30

- 1 Enë zgjerimi
- 2 Fikëse me CO<sub>2</sub>
- 3 Grupi i pompës së furnizimit me ujë
- 4 Matës i nivelit të ujit
- 5 Grupi i pompës kundra zjarrit
- 6 Shkallë

Section,  
Scale 1:30

- 1 Autoclave
- 2 Fire extinguisher CO<sub>2</sub>
- 3 Water supply pump group
- 4 Water level measures
- 5 Fire pump group
- 6 Stairs

Parametrat e pompave llogariten në varësi të numrit të nyjeve hidrosanitare për çdo tualet, si edhe të presionit të nevojshëm që duhet në godinë.

The pump parameters are calculated based on the number of hydrosanitary fixtures in each bathroom and the required pressure for the building.

# Matësa uji

## Water meters

Grup matësat e ujit janë të përbërë nga disa element me funksion kryesor në një apartament, duke nisur nga saraçineskat komanduese për apartamentet në rast avarie, filtri i ujit për eliminimin e papastërtive, reduktori i presionit për rregullimin e presionit të ujit brenda apartamentit, kundralvula për të penguar kthimin e ujit në rrjet, dhe nga elementi kryesor matësi i ujit. Këto grup matësa pozicionohen në katin nëntokë të vendosura në ambientet e përbashkëta për të qenë të aksesueshëm në çdo kohë. Çdo apartament ka linjën e furnizimit me ujë të dedikuar, të pandikuar nga avaritë e mundura në objekte të tjera.

The water meter group consists of several elements with a primary function in an apartment, starting with the control shut-off valves for the apartment in case of an emergency, the water filter to eliminate impurities, the pressure reducer to regulate the water pressure inside the apartment, the check valve to prevent water from flowing back into the network, and the main water meter. These water meters are positioned on the underground floor, in common areas, for access at any time. Each apartment has its own dedicated water supply line, unaffected by potential issues in other parts of the building.





Prerje,  
Shkalla 1:75

- 1 Rakorderi presioni
- 2 Matës uji
- 3 Tub furnizimi me ujë
- 4 Reduktor presioni
- 5 Valvol ndërprerëse

Section,  
Scale 1:75

- 1 Pressure Regulator
- 2 Water meter
- 3 Water supply pipe
- 4 Pressure reducer
- 5 Shut - off valve



# Furnizim ujë objekt


## Water supply network

Prerje,  
Shkalla 1:200

Section,  
Scale 1:200

1 Linja e funizimit me ujë  
2 Linja e funizimit me ujë të ftohtë  
3 Linja e funizimit me ujë të ngrrohtë

1 Water supply pipe  
2 Cold water supply pipe  
3 Hot water supply pipe



Sistemi i furnizimit me ujë parashikon furnizimin me ujë për nevojat hidrosanitare, ujë të ftohtë dhe ujë të ngrohtë. Impianti i furnizimit me ujë hidrosanitar përbëhet nga rrjeti i shpërndarjes, i cili është rrjeti që shpërndan ujin nga grupi i stacionit të pompave deri në konsumatorë nëpërmjet një sistemi të destinuar për këtë qëllim. Rrjeti i shpërndarjes përbëhet nga një linjë kryesore që vjen nga stacioni i pompimit në ambientin teknik, për në grupin e matësive të ujit në hyrje të çdo objekti.

The water supply system provides water for hydrosanitary needs, including cold and hot water. The hydrosanitary water supply system consists of the distribution network, which is the network that delivers water from the pump station group to the consumers through a dedicated system. The distribution network consists of a main line coming from the pump station in the technical room, leading to the water meters group at the entrance of each building.




# Furnizim ujë apartament

## Apartament water supply


Në impiantin e furnizimit me ujë të apartamenteve, ka rëndësi të veçantë skema e furnizimit dhe materiali i përdorur. Skema që është aplikuar për këtë impiant parashikon që linja e furnizimit nga rrjeti urban të furnizojë depon e ujit. Me anë të pompave, uji dërgohet në linjën kryesore të furnizimit të grupit të kontatoreve, dhe më pas, përmes linjave të veçanta, furnizohet çdo apartament.

In the water supply system for apartments, the supply scheme and the materials used are of particular importance. The scheme applied for this system provides that the water supply line from the urban network feeds into the water tank. Using pumps, the water is then delivered to the main supply line of the meter group, and subsequently, through separate lines, each apartment is supplied.



Sistemi i furnizimit brenda në tualete realizohet me një sistem kolektor me tuba multistradë, me dimensione  $\text{Ø}16\text{-}\text{Ø}20$  mm, të përbërë nga 3 shtresa dhe të termoizoluara. Rrjeti i jashtëm i furnizimit me ujë përbëhet nga pjesë gravitacionale dhe pjesë nën presion, që shfrytëzon kushtet e terrenit, duke kombinuar gjithashtu pompat e ujit për të shpërndarë ujin nëpër linjat e veçanta të konsumatorëve.

The internal water supply system within the bathrooms is made with a collector system using multilayer pipes with dimensions  $\text{Ø}16\text{-}\text{Ø}20$  mm, consisting of three layers and insulated thermally. The external water supply network is composed of both gravitational and pressurized sections, utilizing the terrain conditions and also incorporating water pumps to distribute water through the separate lines to the consumers.



Prerje,  
Shkalla 1:50

- 1 Funizim me ujë të ftohtë
- 2 Funizim me ujë të ngrohtë
- 3 Kolektor i funizim me ujë

Section,  
Scale:50

- 1 Cold water supply
- 2 Hot water supply
- 3 Water supply manifold



# Rakorderi presioni

## Pressure regulator

Rakorderi i presionit që ne përdorim ndihmon në ruajtjen e një presioni të qëndrueshëm dhe të sigurt në tubacione, duke mbrojtur pajisjet dhe duke siguruar funksionim optimal. Siguron një rrjedhje të qëndrueshme dhe të barabartë të ujit, duke parandaluar goditjet hidraulike.

The pressure regulator we use helps maintain a stable and safe pressure within the piping system, protecting equipment and ensuring optimal operation. It ensures a consistent and even water flow, preventing hydraulic shot.




Prerje,  
Shkalla 1:20

- 1 Brryl zingato
- 2 Grupi i pompës së furnizimit me ujë
- 3 Xhunto antivibruese
- 4 Saracineske uji
- 5 Brryl
- 6 Enë zgjerimi
- 7 Valvol mos kthimi

Section,  
Scale 1:20

- 1 Elbow pump
- 2 Water supply pump group
- 3 Anti-vibrations joints
- 4 Water valves
- 5 Elbow pump
- 6 Autoclave
- 7 Non-return valve




# Kondicionim

## Air conditioning


Tipologjia e impiantit të kondicionimit është impiant ngrohje/ ftohje me gaz me zgjerim direkt, me sistem multisplit për çdo apartament. Njësitë e brendshme murale apo dyshemeje shërbejnë për të ngrohur ambientin në dimër dhe për ta ftohur (freskim) në verë. Për largim e lagështisë (kondensës) pajisja lidhet me një tubacion PP dhe përfundon në rrjetin e ujrave të shiut.

The type of air conditioning system is a heating/cooling system with direct expansion gas, using a multi-split system for each apartment. The internal wall-mounted or floor-mounted units serve to heat the space in winter and cool (refresh) it in summer. To remove humidity (condensation), the system is connected to a PP piping that leads to the stormwater drainage system.



Tubat e bakrit Cu janë për agjentë ftohës R410A dhe izolohen me një material të posaçëm për të mos lejuar humbjet e nxehtësisë apo fenomenin e kondesimit, lidhjet realizohen me saldimit ose me shtrëngim sipas standardit UNI EN 378. Njësia qendrore e këtij sistemi pozicionohet në llozhën e objektit, duke lënë kështu të lirë fasadën dhe çdo ambient tjetër të apartamentit.

The copper pipes (Cu) are designed for R410A refrigerant and are insulated with a special material to prevent heat loss or condensation. The connections are made by soldering or compression according to the UNI EN 378 standard. The central unit of this system is positioned in the technical shaft of the building, leaving the facade and all other spaces in the apartment free.



Prerje,  
Shkalla 1:30

Section,  
Scale 1:30

1 Njësia e brendshme e kondicionimit  
2 Përçues për instalime elektrike  
3 Përçues për linjat e ftohta


1 Indoor unit  
2 Conduit for wiring  
3 Conduit for refrigerant lines

# Hidrosanitare

## Plumbing fixtures

Pajisjet sanitare që përdoren në tualete janë: WC, bide, lavaman të shoqëruar me rubineterinë përkatëse, grup lavamani, grup bideje, grup dushi. WC dhe bide janë pajisje inkaso të varura në mur, edhe grupi i dushit inkaso 2 funksional, duke e kthyer kështu tualetin në një ambient funksional dhe estetik gjithashtu. Të gjitha pajisjet lidhen me sistemin e furnizimit me ujë dhe të shkarkimit nëpërmjet rakorderive përkatëse. Gjithashtu për ujin e ngrohtë sanitar përdoren boilerat elektrikë të kapaciteteve 80 dhe 100 litra, që bëjnë të mundur furnizimin me ujë të ngrohtë të pajisjeve.

The sanitary wares used in bathrooms include: WC, bidet, washbasin, along with the corresponding faucets, washbasin mixers, bidet mixers, and shower mixers. The WC and bidet are wall-hung units, while the shower mixer is a two-functional unit, transforming the bathroom into both a functional and aesthetically pleasing space. All fixtures are connected to the water supply and sewage system through the appropriate fittings. Additionally, for hot sanitary water, electric water heaters with capacities of 80 and 100 liters are used, providing hot water to the fixtures.



Prerje,  
Shkalla 1:30

Section,  
Scale 1:30

1 Koka e dushit  
2 Lavatriçe  
3 WC  
5 Bide

1 Shower Head  
